



Hyrje

E nderuar Znj. Kryetare e Kuvendit,
Të nderuar deputetë të Kuvendit të Shqipërisë,

Paraqitja në Kuvendin e Shqipërisë e raportit vjetor të punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është një detyrim ligjor. Në rastet kur viti kalendarik për të cilin raportohet korespondon me vit zgjedhor, siç është 2011, është një përgjegjësi e shtuar institucionale për të dhënë jo vetëm një paraqitje të detajuar të zhvillimeve të procesit zgjedhor, problematikave të evidentuara, por edhe të një opinionit e sugjerimeve për adresimin e nevojshëm ligjor të problemeve në kuadër të zgjidhjes sa më oportune të tyre në të ardhmen.

Raporti i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2011 duke reflektuar çështjet më të rëndësishme të procesit të votimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore në Shqipëri synon të nxisë përgjegjësinë e të gjithë aktorëve e faktorëve të fushës me qëllim shfrytëzimin e të gjithë potencialeve në funksion të arritjes së standardeve më të larta të zgjedhjeve demokratike, të cilat nuk janë dhe nuk mund të kuptohen vetëm si sfida e një institucioni, e një subjekti politik, por si sfida e të gjithë kombit, përmbushja e së cilës kushtëzon proceset integruese të vendit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, si organi më i lartë shtetëror i përhershëm, i ngarkuar nga ligji për administrimin e zgjedhjeve, nuk është një institucion për të gjykuar sjelljet e faktorëve politikë të cilët kanë një rol kyç në mbarëvajtjen e procesit. Integriteti i procesit zgjedhor, respektimi i së drejtës kushtetuese të votës, lirisë dhe barazisë së saj, janë dhe do të mbeten në të ardhmen drejtimet për të cilat Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, si një nga aktorët kyç të fushës duhet të japë mendime apo dhe të veprojë në mënyrë energjike në situatë të caktuara.

Pavarësisht opinioneve, akuzave në adresë të punës së KQZ për vitin që lamë pas, jo pa kënaqësi do t'i referoheshim raportit final të OSBE ODHIR për zgjedhjet vendore të vitit 2011, raport i cili vlerëson në mënyrë të drejtë e të paanshme çdo aspekt të punës sonë si arbitër të zgjedhjeve. Në raport, zgjedhjet e 8 majit 2011 vlerësohen nga arbitri ndërkombëtar si kompetitive dhe transparente. Kompetitiviteti dhe transparenca e vlerësuar, si shtylla kryesore të ndershmërisë dhe lirisë së zgjedhjeve, janë vlerësime të çmuara për arritjet e sistemit zgjedhor në Shqipëri, dhe në kuadër të këtij vlerësimi KQZ gjen me vend të evidentojë punën e saj për numërimin, vlerësimin dhe adresimin e çdo vote e vullneti të shprehur të shqiptarëve. OSBE ODHIR, ndërsa në raportin për zgjedhjet e 2009 cilësonte se KQZ mori një sërë hapash për rritjen e transparencës së procesit, në raportin e vitit 2011 procesi zgjedhor cilësohet si transparent, pra KQZ falë paanësisë,

Adresa:
Pallati i Kongreseve,
Blvd. Dëshmoret e Kombit,
Tirane,

Tel./Fax.
+355 (4) 23 53 63

Website: www.ccc.org.al

E-mail
infosec@ccc.org.al





përkushtimit e profesionalizmit të saj, ka arritur përmirësime të vlerësuara në punën e saj.

Rekomandimi i OSBE/ODIHR-it se numërimi, vlerësimi dhe trajtimi i votave të hedhura në kutinë e gabuar duhet të parashikohet në Kodin Zgjedhor, dëshmon qartësisht për drejtësinë e veprimtarisë dhe vendimarrjes së KQZ, edhe në këtë pjesë aq të debatuar të procesit zgjedhor, duke adresuar nevojën e parashikimit dhe rregullimit në ligj të këtij problemi të evidentuar edhe në proceset zgjedhore pararendëse, por jo të fokusuar e shtruar për zgjidhje.

Ashtu siç praktika e proceseve zgjedhore në vijimësi ka dëshmuar, dhe sikundër theksohet dhe në dokumentin e përbashkët të Komisionit të Venecias dhe OSBE/ODIHR-it, një peshë të madhe në mbarëvajtjen e proceseve zgjedhore ka vullneti i forcave politike. Zhvillimet gjatë proceseve në tërësi, dhe specifikisht ato të vërejtura tek ky i fundit si dhe vlerësimet përfundimtare të OSBE/ODHIR dëshmojnë sërish se procesi i krijimit të besimit të plotë të partive politike tek procesi i votimit në tërësi ende nuk ka përfunduar.

E nderuar Znj. Kryetare e Kuvendit,
Të nderuar deputetë të Kuvendit të Shqipërisë,

Në mbyllje, duke përsëndetur:

Punën e komisionit për reformën zgjedhore;

Produktin e pritshëm për një legjislacion zgjedhor gjithpërfshirës dhe të detajuar në çdo aspekt;

Një vullnet më të mirë të aktorëve kyç për mbarëvajtjen e proceseve zgjedhore në Shqipëri;

Si dhe duke shprehur besimin se opinioni i dërguar nga KQZ pranë këtij komisioni për vlerësimet dhe ndryshimet teknike që duhen bërë në Kodin Zgjedhor me qëllim përmirësimin e procesit do të konsiderohen, shpreh bindjen se do të arrihet të garanohet zhvillimi i zgjedhjeve në përputhje të plotë me angazhimet e OSBE-së dhe Këshillit të Evropës dhe standarteve të tjera ndërkombëtare.

Në pritje të përfundimeve të reformës zgjedhore, më lejoni t'ju shpreh në emër dhe të Institucionit të KQZ-së, mirënjohjen për ndihmën dhe mbështetjen e dhënë për përmbushjen e detyrimeve tona ligjore.

Adresa:
Pallati i Kongreseve,
Blvd. Dëshmoret e Kombit,
Tirane,

Tel./Fax.
+355 (4) 23 53 63

Website: www.cec.org.al

E-mail
infosec@cec.org.al





BURIMET NJERËZORE

Burimet njerëzore në KQZ të pozicionuar sipas strukturë-organikës së saj, janë konsideruar si asete të çmuara të institucionit, të aftë, të kualifikuar për përgatitjen, dhe mirëorganizimin e proceseve zgjedhore, si dhe janë burime të qëndrueshme konsulente për të gjithë aktorët dhe faktorët të përfshirë në zgjedhje.

Aktualisht KQZ ka 55 punonjës organikë, 7 anëtarë dhe 48 punonjës të administratës, nga të cilët 30 trajtohen me statusin e nëpunësit civil dhe 18 trajtohen si punonjës mbështetës.

Për zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve në drejtim të efektivitetit dhe profesionalizmit të punonjësve të përhershëm të administratës, janë realizuar:

- Trajnime, lidhur me detyrat funksionale në përputhje me Kodin Zgjedhor dhe rekomandimet e OSBE/ODIHR, në funksion të produktivitetit dhe efikasitetit për realizimin me korrektësi të zgjedhjeve.
- Kurse trajnime periodike të të gjithë nëpunësve të administratës në bashkëpunim me ITAP, sipas temave që u shërbejnë detyrave funksionale që ata kanë, për mënyrën e organizimit dhe të menaxhimit të punës së gjithsecilit dhe zgjidhjen e situatave të ndryshme të lindura gjatë punës në grup.
- Pjesëmarrja e nëpunësve të administratës në aktivitete të zhvilluara lidhur me proceset zgjedhore, si dhe vëzhgimi i disa proceseve zgjedhore jashtë Shqipërisë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 8 Maj 2011, në zbatim të vendimeve të tij, punësoi:

- 293 punonjës të përkohshëm, nga të cilët 91 ndihmës specialistë dhe 202 punonjës mbështetës, si asistent të punonjësve të përhershëm të Administratës së KQZ-së,
- 24 Inspektor dhe Nd/inspektor Rajonal Zgjedhor,
- 40 trajnues, të cilët kryen trajnimin e anëtarëve të Komisioneve të Zonave të Administrimit të Zgjedhjeve,
- 220 trajnues, të cilët kryen trajnimin e anëtarëve të Qendrave të Votimit dhe Grupeve të Numërimit të votave.

Procedurat e rekrutimit dhe të punësimit të këtij kontingjenti (punonjës) u mbështetën në transparencën e këtij procesi, duke marrë parasysh dokumentacionin e kërkuar mbi bazën e kritereve të shpallura për punësim, të cilat përkonin përgjithësisht me ato të specialistëve organikë të institucionit, pasi detyrat që ata kryen ishin përputhshmërisht në përshtatje profesionale me punonjësit organikë të Administratës së KQZ.

Adresa:
Pallati i Kongreseve,
Blvd. Dëshmoret e Kombit,
Tirane,

Tel./Fax.
+355 (4) 23 53 63

Website: www.ccc.org.al

E-mail
infosec@ccc.org.al





Personeli i përkohshëm me fillimin e detyrës u kualifikua për proceset e punës nëpërmjet trajnimeve specifike, ndihmuar dhe asistuar nga administrata e KQZ-së, me synim disiplinimin e realizimit të detyrave për çdo proces pune, operimin me efektivitet, korrektësinë në zbatim të Kodit Zgjedhor dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Sa më sipër, mund të themi se gjatë vitit 2011, i cili përkoi edhe me zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, Administrata e KQZ-së, është karakterizuar nga fryma e bashkëpunimit, profesionalizmit, racionalitetit, paanshmërisë, zbatimit të ligjit, duke luajtur një rol mjaft të rëndësishëm në mbarëvajtjen dhe transparencën e procesit zgjedhor.

PLANIFIKIMI DHE KOORDINIMI-PËRGATITJA E INFRASTRUKTURËS LOGJISTIKE PËR ZGJEDHJET E DATËS 8 MAJ 2011

Plani i veprimit për zgjedhjet e datës 8 maj 2011

Me daljen e dekretit të Presidentit të Republikës, nr. 6668, datë 06.09.2010 "Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore", KQZ në përmbushje të detyrimeve të saj ligjore, u angazhua menjëherë për përgatitjen, organizimin dhe administrimin e këtyre zgjedhjeve. Referuar praktikave më të mira zgjedhore, të zhvilluara në zgjedhjet e mëparshme, në fushën e planifikimit dhe koordinimit për zgjedhjet, në funksion të miradministrimit të procesit zgjedhor, u koordinua puna me drejtoritë në KQZ, me qëllim përcaktimin e afateve kohore për nxjerrjen nga KQZ të akteve nënligjore (vendime, udhëzime), veprimeve konkrete që duheshin ndërmarrë, si dhe procedurave që duheshin ndjekur në periudhën parazgjedhore, ditën e zgjedhjeve, procesin e numërimit të votave dhe periudhën paszgjedhore. Të gjitha këto masa u paracaktuan në planin orientues të veprimit të miratuar me vendimin nr. 29, datë 01.10.2010, vendimmarrje e cila shërbeu jo vetëm për ngritjen dhe zhvillimin e infrastrukturës zgjedhore, por edhe si pikë referimi për punën në vijimësi të administratës së KQZ-së.

Me procedura ligjore dhe transparente, mbështetur në Kodin Zgjedhor dhe aktet nënligjore të miratuara nga KQZ-ja, u realizua ngritja e infrastrukturës zgjedhore të domosdoshme për mbarëvajtjen e zgjedhjeve.

Përgatitja e infrastrukturës zgjedhore, për zgjedhjet e datës 8 maj 2011

Hapi i parë për përgatitjen e infrastrukturës zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 8 Maj 2011 ishte vlerësimi i gjendjes së një numri të konsiderueshëm të materialeve zgjedhore, kryesisht kutive të votimit dhe kutive të

Adresa:
Pallati i Kongreseve,
Blvd. Dëshmoret e Kombit,
Tirane,

Tel./Fax:
+355 (4) 23 53 63

Website: www.cec.org.al

E-mail:
infosec@cec.org.al





materialeve zgjedhore. Pjesë e këtij procesi është Vendimi nr. 51, datë 29.12.2010 "Për hapjen e kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore të përdorura për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 28 Qershor 2009".

Pas përfundimit të procesit në tërësi, i gjithë dokumentacioni i parashikuar u dorëzua në Arkivin e Shtetit, ndërsa materialet e tjera zgjedhore u rivlerësuan për gjendjen e tyre fizike dhe u riinventarizuan. Në bazë të këtij procesi, administrata e KQZ-së filloi edhe përgatitjet konkrete për ngritjen e infrastrukturës zgjedhore.

Në përfundim të procesit të hapjes së kutive, KQZ konstatoi dëmtimin e një numri të konsiderueshëm të kutive të materialeve zgjedhore, si pasojë e përdorimit të gjatë në kohë të tyre, duke bërë që numri total i këtyre kutive që mund të ripërdorej të ishte më i vogël se numri i QV-ve që do të funksiononin ditën e votimit. Për rrjedhojë, ishte e domosdoshme sigurimi i kutive të materialeve zgjedhore shtesë, specifikimet dhe sasia e të cilave u miratuan me Vendimin nr. 99, datë 25.01.2011 të KQZ-së.

Vlen të evidentohet fakti se planifikimi në kohën e duhur i bazës logjistike zgjedhore nga çdo drejtori, disponimi i saj në sasi dhe cilësinë e kërkuar në specifikimet teknike dhe dërgimi i saj në destinacionin e duhur (pranë çdo KZAZ), si rrallë ndonjëherë para afatit kohor të parashikuar në Kodin Zgjedhor, flasin për një planifikim korrekt, si dhe koordinim perfekt të punës të strukturave të administratës së KQZ-së.

Çdo Komision Zonal i Administrimit të Zgjedhjeve (KZAZ) dhe Komision i Qendrës së Votimit (KQV) ka patur në dispozicion të gjithë dokumentacionin dhe materialet zgjedhore të domosdoshme për zbatimin e procedurave dhe përmbushjes së detyrave që, Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, u ngarkon këtyre komisioneve.

Duke filluar nga dita e konstituimit të 66 KZAZ-ve, KQZ ka siguruar ndihmën profesionale me stafin teknik të KQZ-së në secilën prej KZAZ-ve dhe duke i pajisur njëkohësisht me gjithë dokumentacionin dhe bazën materiale të nevojshme për fillimin e funksionimit të këtyre strukturave zgjedhore.

Nisur nga fakti se një pjesë e konsiderueshme e materialeve zgjedhore konsiderohen sensitive dhe disa prej tyre janë të parashikuara në dispozitat e Kodit Zgjedhor, KQZ ka nxjerrë të gjitha aktet nënligjore në funksion të plotësimit të infrastrukturës zgjedhore për zgjedhjet e datës 8 Maj 2011. Ky proces është zhvilluar në transparencë të plotë dhe me pjesëmarrjen e të gjitha palëve të interesuara dhe përfaqësuesve të institucioneve ndërkombëtare që kanë asistuar dhe monitoruar punën e KQZ-së gjatë periudhës zgjedhore.

Adresa:
Pallati i Kongreseve,
Blvd. Dëshmoret e Kombit,
Tirane,

Tel./Fax.
+355 (4) 23 53 63

Website: www.ccc.org.al

E-mail
infosec@ccc.org.al





KUADRI I PËRGJITHSHËM LEGJISLATIV DHE ROLI I PARTIVE POLITIKE

Zhvillimi i zgjedhjeve në Republikën e Shqipërisë, bëhet mbi bazën e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Kodit Zgjedhor, ligjeve të tjera të dala në bazë dhe për zbatim të Kushtetutës dhe akteve nënligjore.

Në hartimin e akteve nënligjore gjatë një procesi zgjedhor në KQZ rol aktiv të rëndësishëm kanë dhe partitë politike. Partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje nëpërmjetë përfaqësuesve të tyre në KQZ kanë të drejtë të paraqesin kërkesa dhe të japin propozime të ndryshme për hartimin e akteve nënligjore. Në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore 2011 u vu re mungesa e përfaqësuesve të disa partive politike në fazën e hartimit të akteve nënligjore në KQZ. Kjo mungesë bëri që disa parti politike të mos kontribuojnë në këtë fazë të rëndësishme të procesit zgjedhor.

NXJERRJA E AKTEVE NËNLIGJORE

Në zbatim të kompetencave ligjore, përcaktuar në Kodin Zgjedhor, KQZ për administrimin e këtij procesi zgjedhor ka emetuar gjithsej 1229 akte, një pjesë shumë e vogël e të cilave kanë qenë udhëzime.

Për këto zgjedhje u zbatuan Udhëzimet e miratuara nga KQZ gjatë vitit 2009, të cilat përcaktojnë në mënyrë të qartë të gjitha procedurat që do të ndiqeshin prej subjekteve zgjedhore si dhe komisioneve të niveleve më të ulta, me qëllim garantimin e një procesi të drejtë zgjedhor, administrimit transparent të tij, si dhe të barazisë për të gjithë subjektet zgjedhore pjesëmarrëse në të. Këto akte kanë qenë adekuate dhe rregullonin në përgjithësi marrëdhëniet në lidhje me organizimin e zgjedhjeve për Organet e Qeverisjes Vendore. Në mbështetje të nenit 24 të Kodit Zgjedhor, KQZ duhet të nxjerrë aktet me karakter normativ jo me vonë se 60 ditë para datës së zgjedhjeve. Mungesa e disa anëtarëve të KQZ-së solli vështirësi për hartimin e udhëzimeve të reja të nevojshme apo ndryshimin e atyre ekzistuese për të rregulluar marrëdhëniet specifike në lidhje me zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore.

Vendimet e miratuara nga KQZ për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 08.05.2011 kanë pasur objekt kryesisht rregullimin e regjistrimit të subjekteve zgjedhore në KQZ, modelet e dokumentacionit të punës të komisioneve të niveleve të dyta e të treta, manualët zgjedhore, emërime dhe zëvendësime të komisionerëve zgjedhorë, modelet e materialeve logjistike, shqyrtimin e kërkesave ankimore, marrëveshjet e ndryshme të bashkëpunimit, monitorimin e pasqyrimin të fushatës zgjedhore në media, akreditimin e vëzhguesve vendorë apo të huaj, marrjen e masave administrative në raste të caktuara, miratimin e tabelave përmbledhëse të rezultateve të ZAZ-ve, shpalljen e kandidatëve fitues nga listat

Adresa:
Pallati i Kongreseve,
Blvd. Dëshmoret e Kombit,
Tirane,

Tel./Fax:
+355 (4) 23 53 63

Website: www.ccc.org.al

E-mail:
infosec@ccc.org.al





shumemërore për këshillat e Bashkive dhe Komunave, nxjerrjen e rezultatit të zonës zgjedhore Bashkia Tiranë, etj.

EDUKIMI I ZGJEDHËSVE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr.47, datë 15.12.2010, miratoi strategjinë për edukimin zgjedhor të shtetasve, për Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore, të datës 08.05.2011.

Kjo strategji ka synuar perceptimin e më pas ndërtimin e projekteve edukuese, prioritetet e veprimeve, kohën e zbatimit të programeve të ndryshme etj. Aspekti tjetër i kësaj strategjie ishte ndërtimi i projekteve për target-grupe specifike, duke patur parasysh edhe problematikat e përmendura në raportet e zgjedhjeve të mëparshme.

KQZ, me vendimin nr.27, datë 18.02.2011, miratoi projektin "Fushata e edukimit të zgjedhësve për Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore 2011", qëllimi kryesor i të cilit ishte pajisja e të gjithë shtetasve me informacionin e nevojshëm zgjedhor. Gjatë implementimit të fushatës, u vlerësua si prioriteti kryesor gjetja e metodave dhe formave bashkohore, në përcjelljen e mesazheve kyçe.

Fushata e edukimit të zgjedhësve u fokusua në mënyrë të veçantë në ndalimin e votimit familjar dhe edukimin e zgjedhësve që votojnë për herë të parë. Në këtë kuadër, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka pasur bashkëpunim shumë të mirë me OSCE, UN-ËOMEN, Ambasadën Italiane, KE për implementimin e projekteve të ndryshme në ndihmë të grupeve të lartpërmendura.

Në kuadër të edukimit të zgjedhësve janë prodhuar 5 spote TV dhe radio, të fokusuara në: sensibilizim, procedurat dhe hapat e veprimit në një qendër votimi, kundër votimit familjar, sensibilizim për të rinjtë dhe ata që votojnë për herë të parë.

Transmetimi i të gjitha spoteve është kryer si në mediat kombëtare ashtu edhe në mediat lokale me qëllim që të arrihet një audiencë maksimale.

Krahas këtyre, në vijim të fushatave specifike, janë prodhuar një numër në rritje i materialeve të tjera promocionale të cilat janë shpërndarë në të gjitha rrethet e vendit dhe kanë pasur një impakt mjaft pozitiv.

REGJISTRIMI I KANDIDATËVE DHE PARTIVE POLITIKE

Për zgjedhjet për organet e Qeverisjes Vendore janë regjistruar si subjekt zgjedhor gjithsej 56 parti politike. Për Bashkinë e Tiranës regjistruan lista shumemërore në KQZ gjithsej 36 subjekte zgjedhore.

Gjitashtu u regjistruan në KQZ, për Bashkinë e Tiranës tre kandidatë për kryetar.

Adresa:
Pallati i Kongreseve,
Blvd. Dëshmoret e Kombit,
Tiranë,

Tel./Fax.
+355 (4) 23 53 63

Website: www.cec.org.al

E-mail
infosec@cec.org.al





Në këtë fazë të procesit KQZ konstatoi në një rast fenomenin e mosbatimit të ligjit që lidhej me respektimin e barazisë ligjore në listën shumemërore për Këshillin e Bashkisë Tiranë. Në këtë rast, KQZ në mbështetje të nenit 67 të Kodit Zgjedhor vendosi sanksion administrativ për subjektin zgjedhor që nuk respektoi barazinë gjinore (një në cdo tre emra t'i përkasë secilës gjini) në listën shumemërore për këshillin e Bashkisë Tiranë.

Gjithashtu nga verifikimi që KQZ bëri kryesisht në listat shumemërore të partive politike të depozituara në KZAZ rezultoi se nga 54 parti të cilat depozituan lista shumemërore, 53 prej tyre nuk respektuan kriterin e gjinisë në një numër të konsiderueshëm zonash zgjedhore. Nisuar nga fakti se KZAZ-të, për shkak dhe të funksionimit të tyre në këtë fazë me kapacitet jo të plotë (4 anëtar nga 7), si dhe duke qenë se për herë të parë kishin një ngarkesë të konsiderueshme që lidhej me regjistrimin e kandidatëve dhe listave shumemërore, nuk pasqyruan në dokumentacionin zgjedhore, rastet e shkeljes së kriterit të gjinisë. Në këto kushte dhe vendosja e sanksioneve administrative nga KQZ brenda afateve të përcaktuara në ligj, u bë i pamundur.

REGJISTRIMI I VEZHguesVE TË ZGJEDHJEVE

Në vëzhgimin e zgjedhjeve për Organet e Qeverisjes Vendore 2011 u angazhuan një numër relativisht i lartë vëzhguesish si vendas ashtu dhe të huaj. Për ndjekjen e procedurave të akreditimit të vëzhguesve vendas dhe të huaj, çka përfshin përcaktimin e rregullave të vëzhgimit të procesit zgjedhor, akreditimit, të drejtat dhe detyrat, kriteret dhe standartet për vëzhgimin e zgjedhjeve nga organizatat jofitimprurëse shqiptare, organizmat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave, KQZ u bazua në Udhëzimin Nr. 13, datë 22.04.2009.

Në totalin e kërkesave të mbërritura, vetëm 4 prej tyre janë rrëzuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për shkak të tejkalimit të afatit në dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar apo për mungesë të këtij të fundit. **Në total është regjistruar numri 5118 i vëzhguesve prej të cilëve 485 janë vëzhgues të huaj dhe 4633 janë vëzhgues vendas.**

Nga vëzhguesit vendas, 4617 përfaqësonin organizatat joqeveritare (OJQ-të). 18 OJQ u bashkuan si Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë, i cili shpërndau rreth 170 vëzhgues afatgjatë dhe mbi 900 vëzhgues afatshkurtër.

Në sajë të një procesi pune, tashmë të mirëpërcaktuar që nga marrja e kërkesës për akreditim e deri në përgatitjen e autorizimeve e më pas shpërndarjen e tyre u arrit që të trajtohet në kohë dhe pa asnjë problem akreditimi i 5118 vëzhguesve jopolitikë.

Adresa:
Pallati i Kongreseve,
Blvd. Dëshmoret e Kombit,
Tirane,

Tel./Fax:
+355 (4) 23 53 63

Website: www.ccc.org.al

E-mail:
infosec@ccc.org.al





MARRJA E INFORMACIONIT PËR QV-TË, ZGJEDHËSIT, HARTAT ZGJEDHORE NGA NJËSITË E QEVERISJES VENDORE

Për të realizuar detyrimet që kanë njësitë e qeverisjes vendore për zgjedhjet, mbështetur në Kodin Zgjedhor, KQZ me një akt normativ, Udhëzimin Nr.3, qysh në vitin 2009, ka përcaktuar detyrat dhe afatet e realizimit të tyre nga këto njësi. Në komunikime shkresore KQZ edhe për zgjedhjet e vitit 2011 u kërkoi kryetarëve të njësive të qeverisjes vendore të sillnin në KQZ informacionin përkatës në afatet e përcaktuara si për listën paraprake dhe atë përfundimtare të zgjedhësve. Disa Kryetarë të Njësive të Qeverisjes Vendore, nuk dorëzuan në KQZ hartat dhe të dhëna mbi qendrat e votimit, brenda afateve ligjore të përcaktuara në Kodin Zgjedhor. Për këtë KQZ në mbështetje të nenit 171 pika 1, të ligjit nr 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" vendosi sanksione administrative për ata kryetarë të njësive të qeverisjes vendore të cilët nuk zbatuan dispozitat e Kodit Zgjedhor.

Informacioni i sjellë për QV-të dhe numrin e zgjedhësve në to sipas listës paraprake u sistemua në bazën e të dhënave dhe u përdor për përgatitjen e projektbuxhetit të zgjedhjeve. Kodi Zgjedhor ia ka dhënë kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore kompetencën për krijimin e një QV-je shtesë kur një zonë QV-je ka më shumë se 1000 zgjedhës dhe bashkimin e një QV-je që ka më pak se 150 zgjedhës. Koha për ushtrimin e kësaj kompetence përfundon me përgatitjen e listës paraprake të zgjedhësve. Me gjithë përpjekjet e bëra dhe tërheqjen e vazhdueshme të vëmendjes nga ana jone, një numër i konsiderueshëm pushtetarësh vendorë nuk i realizuan në kohë detyrimet e tyre dhe bënë ndryshime të sasisë së QV-ve edhe pas miratimit të listës paraprake të zgjedhësve. Vonesa pati edhe për sjelljen e informacionit për numrin e QV-ve dhe të numrit të zgjedhësve në to sipas listës përfundimtare, aq të domosdoshme për prodhimin e fletëve të votimit dhe përgatitjen e logjistikës tjetër zgjedhore.

Me gjithë çrregullimet e ndodhura në procesin e marrjes së informacionit KQZ vendosi të bëhej krahasim midis informacionit të sjellë nga kryetarët e njësive vendore në KQZ dhe atij që kishin marrë KZAZ-të dhe pas verifikimeve dhe reflektimit të ndryshimeve miratoi sasinë e fletëve të votimit që duhet të prodhoheshin për çdo QV. Sasia e fletëve të votimit të miratuar për prodhim, duke përfshirë dhe ato për organet e njësive bashkiake të Tiranës, arriti në total 7.441.838 cope për të 4882 QV-të (për kryetar 3.720.919 copë dhe po kaq për fletën e votimit për këshillin).

Për të mos krijuar probleme në përgatitjen e logjistikës zgjedhore mendojmë se afatet për përgatitjen e Listës së Zgjedhësve duhet të ndryshohen. Konkretisht, lista përfundimtare duhet të jetë miratuar jo më

Adresa:
Pallati i Kongreseve,
Blvd. Dëshmoret e Kombit,
Tirane,

Tel./Fax:
+355 (4) 23 53 63

Website: www.ccc.org.al

E-mail:
infosec@ccc.org.al





vonë se 35 ditë para datës së zgjedhjeve dhe jo më vonë se 30 ditë nga data e zgjedhjeve të jenë dërguar të dhënat përkatëse në KQZ.

Në zgjedhjet vendore 2011 në të gjithë vendin ishin 4882 QV me gjithsej 3.166.279 zgjedhës. Mesatarja zgjedhës për QV në rang vendi ishte 649 zgjedhës (në bashki ishte 916, ndërsa në komuna ishte 469 zgjedhës).

Në bazë të Kodit Zgjedhor numri i zgjedhësve për një QV nuk duhet të jetë më i vogël se 150 dhe më i madh se 1000 zgjedhës. Në këto zgjedhje kishim 467 QV me më pak se 150 zgjedhës dhe 941 QV me më shumë se 1000 zgjedhës.

Në disa raste kryetarët e njësive vendore, përcaktuan në mënyrë antiligjore dhe në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në Kodin Zgjedhor, vendodhjen e disa QV-ve. Nisur nga ankesat e disa subjekteve zgjedhore, KQZ ndërhyri për korigjimin e këtyre veprimeve, duke i detyruar kryetarët e njësive vendore të ndryshojnë vendimarrjet e tyre.

PARANDALIMI I PRAKTIKAVE ANTILIGJORE NË ZGJEDHJE

KQZ në periudhën para datës së zgjedhjeve në fazën e përgatitjes për organizimin e zgjedhjeve të datës 8 maj, krijoi disa praktika, të cilat synonin parandalimin dhe eliminimin e fenomeneve antiligjore të ndeshura në zgjedhjet e kaluara. Të tilla janë: plotësimi i vendeve vakante në komisionet e niveleve të dyta për shkak se partitë politike të opozitës parlamentare nuk kishin paraqitur propozimet për anëtarë të këtyre komisioneve dhe kështu rrezikohej seriozisht vazhdimësia e procesit zgjedhor. Plotësimi i vendeve vakante dhe krijimi i kuorumit të nevojshëm në këto komisione u bë nëpërmjet një procedure të rregullt rekrutimi dhe njoftimeve në median e shkruar të cilave iu përgjigjën një numër i madh kërkesash nga shoqëria civile.

Gjithashtu prodhimi i vulave rezervë për të gjitha KQV-të ishte një tjetër praktikë që synoi parandalimin e bllokimit të votimit nga komisionerë të caktuar duke marrë vulën me vete. KQZ me vendimin nr.493, datë 28.04.2011 "Për Miratimin e modelit dhe sasisë së vulës rezervë për qendrat e votimit që do të përdoren në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 08.05.2011", përcaktoi modelin e vulës rezervë për qendrat e votimit, sasinë e vulave rezervë që do të prodhohej, e barabartë kjo me numrin e qendrave të votimit në të gjithë vendin si dhe mënyrën e mbajtjes duke ngarkuar inspektorët rajonalë me mbajtjen dhe ruajtjen e tyre. Pavarësisht debatit të paragjykuar, vendimi rezultoi i drejtë dhe realisht dha efektet e parashikuara.

Praktika e zgjedhjeve të mëparshme tregoi se një fenomen antiligjor ndodhur rëndom ishte dhe mosparaqitja e komisionerëve të qendrave të votimit, të një

Adresa:
Pallati i Kongreseve,
Blvd. Dëshmoret e Kombit,
Tirane,

Tel./Fax:
+355 (4) 23 53 63

Website: www.ccc.org.al

E-mail:
infosec@ccc.org.al





force politike pranë KZAZ, për të marrë kutitë e votimit dhe materialet e tjera zgjedhore. Ky fenomen shkaktonte moshapjen e qendrave të votimit ditën e votimit dhe si pasojë moszhvillimin e zgjedhjeve në këto QV. KQZ në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore 2011 ndërhyri në mënyrë aktive me vendim, duke përcaktuar rregulla për marrjen në dorëzim të bazës materiale zgjedhore edhe kur komisionerët e një force politike nuk paraqiteshin për të kryer detyrën, që në rastin e parë. Kjo vendimarrje bëri të mundur parandalimin e kthimit të një rasti në fenomen.

FLETA E VOTIMIT

Modeli specifikimet dhe përmbajtja e fletëve të votimit në bazë të Kodit Zgjedhor miratohen nga KQZ. KQZ duke vlerësuar fletën e votimit, si një element të rëndësishëm në besueshmërinë e procesit zgjedhor, i kushtoi rëndësi të veçantë përcaktimit të specifikimeve të fletës së votimit, procesit të përgatitjes së fletëve të votimit, integritetit të prodhimit dhe më tej, shpërndarjes së tyre.

KQZ, në përmbushje të detyrave të veta, me vendimin nr.113, datë 2.03.2011, miratoi modelin e fletëve të votimit për Zgjedhjet Vendore 2011. Pas marrjes së informacionit nga KZAZ-të për regjistrimin e kandidatëve si për kryetar dhe për listat shumëmemërore për këshilltarë, nisur dhe nga propozimet e disa subjekteve zgjedhore, KQZ me Vendim Nr.448, datë 18.04.2011, bëri disa ndryshime të specifikimeve teknike të fletëve të votimit duke marrë dakortësinë e të gjitha subjekteve zgjedhore. Gjithashtu me propozim të disa prej subjekteve zgjedhore KQZ me Vendim Nr.438, datë 18.04.2011 "Për masat e sigurisë në vendin e prodhimit të fletëve të votimit", miratoi një sërë masash ku veç të tjerash u jepte të gjitha subjekteve zgjedhore të drejtën për të vëzhguar procesin e prodhimit të fletëve të votimit gjatë gjithë kohës.

Vlen të përmendet se fleta e votimit, si dhe në zgjedhje të mëparshme, kishte elementë sigurie të përafërt me kartmonedhat, gjë që nuk do të ishte e nevojshme në se do të kishte më shumë besim midis palëve.

Pas regjistrimit pranë KZAZ-ve të kandidatëve për kryetar njësie dhe listave shumëmemërore për këshilltarë, KQZ në përmbushje të detyrimeve të saj ligjore, miratoi përmbajtjen e fletëve të votimit për 384 njësitë e qeverisjes vendore.

Siç dihet subjekte zgjedhore duhet të dorëzojnë pranë KZAZ-ve emrat e kandidatëve për kryetar ose listën shumë emërore të kandidatëve për këshill jo më vonë se 40 ditë përpara ditës së zgjedhjeve. Pas kësaj, në se ka parregullsi në dokumentacionin e paraqitur për kandidimet, lihen afate për rregullim, që e çojnë afatin e miratimit të dokumentacionit të kandidimit nga KZAZ-të deri në 30 ditë

Adresa:
Pallati i Kongreseve,
Blvd. Dëshmoret e Kombit,
Tirane,

Tel./Fax:
+355 (4) 23 53 63

Website: www.cec.org.al

E-mail:
infosec@cec.org.al





para ditës së zgjedhjeve. Duke marrë parasysh edhe kohën që kërkon ankimimi ndaj vendimeve të KZAZ-ve në KQZ dhe në Kolegjin Zgjedhor, afatet kur marrin formë përfundimtare të dhënat për përmbajtjen e fletëve të votimit arrijnë fare pak ditë para ditës së zgjedhjeve. Kjo vë në vështirësi serioze përgatitjen e fletëve të votimit. Për këtë mendojmë se është e nevojshme rishikimi i afateve të regjistrimit të kandidatëve që ndikon më pas afatet e të gjitha proceseve zinxhir që lidhen me regjistrimin, për t'i harmonizuar me afatet e përgatitjes së fletëve të votimit.

Procesi i përgatitjes dhe prodhimit të fletëve të votimit për Zgjedhjet Vendore 2011, proces i cili pavarësisht problemeve sa më lart që kushtëzuan disi kohën e nevojshme për realizimin e tij, u realizua në kohë dhe me standardet e kërkuara, kjo falë vëmendjes dhe masave të ndërmarra nga KQZ.

MEDIA NË FUSHATËN ZGJEDHORE

Ashtu si edhe në zgjedhjet e mëparshme, KQZ-ja në zbatim të dispozitave të Kodit Zgjedhor miratoi Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit për shfrytëzimin e kapaciteteve njerëzore dhe teknike të KKRT-së, për nevojat e monitorimit të fushatës zgjedhore, në radion dhe televizionin publik dhe privat, në funksion të Zgjedhjeve për Organet e Qeverisjes Vendore e vitit 2011. Gjithashtu KQZ ngriti Bordin e Monitorimit të Medias, i cili edhe pse me mangësi anëtarësie në ditët e para të funksionimit të tij, filloi menjëherë nga puna. Në bashkëpunim me KKRT-në bordi përgatiti dhe dërgoi çdo ditë në KQZ raporte të detajuara, sipas kërkesave dhe standardeve të përcaktuara nga kuadri ligjor.

KQZ-ja mori në shqyrtim çdo javë raportet e BMM-së. BMM-ja propozoi marrjen e masave për subjektet transmetuese, duke kërkuar kompensimin në favor të subjekteve zgjedhore, madje edhe vendosjen e gjobave administrative. KQZ-ja i shqyrtoi kërkesat dhe vendosi gjithmonë pranimin e tyre dhe kompensimin në favor të subjektit/kandidatëve të propozuar, por rrëzoi kërkesat për gjoba administrative ndaj 4 operatorëve televizivë.

Padyshim që në zgjedhjet Vendore të 8 Majit, KQZ u përball me disa situata të reja lidhur me pasqyrimin e fushatës zgjedhore të subjekteve politike apo dhe kandidatëve të propozuar prej tyre, situata që sollën mjaft diskutime jo vetëm në sallën e mbledhjeve të KQZ-së, por edhe jashtë saj. Sigurisht që fenomeni, i cili nga vetë mediat u cilësua si 'fushata e regjisë qendrore' apo e kasetave të përgatitura nga vetë kandidatët mbetet më i prekshmi, e njëkohësisht edhe një tjetër tregues se kërkohen rregullime ligjore për të parashikuar apo parandaluar të gjitha fenomenet që janë ndeshur në praktikë, dhe jo vetëm në këtë aspekt.

Në një funksion të arritjes së standardeve më të larta dhe zbatimit sa më të plotë të kuadrit ligjor, KQZ dhe TVSH morën të gjitha masat që të gjithë subjektet e

Adresa:
Pallati i Kongreseve,
Blvd. Dëshmoret e Kombit,
Tirane,

Tel./Fax:
+355 (4) 23 53 63

Website: www.ccc.org.al

E-mail:
infosec@ccc.org.al





regjistruara si pjesëmarrëse në zgjedhjet vendore të merrnin kohën televizive për të dhënë mesazhet e tyre elektorale, konform Kodit Zgjedhor.

Si konkluzion mund të thuhet se, në zgjedhjet Vendore 2011 u arrit të ruhej një pasqyrim në tërësi profesional i aktiviteteve të subjekteve zgjedhore, por u vunë re dhe disbalancime në kohë, në favor të dy koalicioneve më të mëdha, duke mos respektuar pjesërisht përcaktimet e Kodit Zgjedhor.

NIVELET E DYTA TË KOMISIONEVE ZGJEDHORE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin Nr.45, datë 09.12.2010 përcaktoi partitë politike të cilave iu lindi drejta që në bazë të nenit 29 të Kodit Zgjedhor të propozojnë anëtarë në Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhore. (KZAZ) Referuar nenit 28 të Kodit Zgjedhor komisionet e nivelit të dytë duhet të ngriheshin 90 ditë përpara datës së zgjedhjeve, pra me datën 7 Shkurt. Po në zbatim të kësaj dispozite partitë politike të cilat fituan këtë dispozitë duhet të sillnin propozimet e tyre jo më vonë se 15 ditë përpara kësaj date. Këtë afat ligjor e respektuan vetëm Partia Demokratike dhe Partia Lëvizja Socialiste për Integrim. Dy partitë politike të opozitës parlamentare, pra Partia Socialiste dhe Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut megjithë apelin e vazhdueshëm të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nuk i paraqitën propozimet e tyre në afatin e duhur ligjor.

Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhorë në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore kanë një rol shumë të rëndësishëm dhe të vecantë në krahasim me zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë. KZAZ-të regjistrojnë kandidatët për kryetar të njësive të qeverisjes vendore dhe listat shumemërore të partive politike për në këshillat e organeve të qeverisjes vendore. Përfundimisht nga ky rregull bënë vetëm Bashkia e Tiranës për të cilën si kandidatët ashtu dhe listat shumemërore regjistrohen pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Duke qenë se regjistrimi i kandidatëve dhe listave shumemërore referuar nenit 67 të Kodit Zgjedhore ka një afat të përcaktuar ligjor dhe se partitë politike të opozitës parlamentare nuk kishin paraqitur propozimet për anëtarë të këtyre komisioneve të nivelit të dytë rrezikohej seriozisht vazhdimësia e procesit zgjedhore të datës 8 Maj 2011.

Për këtë arsye, si dhe për të eliminuar këto praktika dhe qëndrime antiligjore të partive politike të opozitës parlamentare si dhe për të garantuar një proces të rregullt zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mori vendim për të plotësuar vendet vakante në këto komisione. Sipas këtij vendimi do të plotësoheshin vendet për anëtarin e katërt në ato KZAZ ku mungonte kuorumi i nevojshëm si dhe sekretari në ato KZAZ ku mungonte sekretari i KZAZ-së.

Për këtë arsye u zhvillua një procedurë e rregullt rekrutimi nëpërmjet njoftimeve në median e shkruar. Në përgjigje të kësaj thirrje të KQZ-së u paraqitën afërsisht 110 kërkesa për t'u punësuar pranë KZAZ-ve. Në përfundim të këtij procesi KQZ-ja

Adresa:
Pallati i Kongreseve,
Blvd. Dëshmoret e Kombit,
Tirane,

Tel./Fax:
+355 (4) 23 53 63

Website: www.ccc.org.al

E-mail:
infosec@ccc.org.al





emëroi 66 persona të cilët plotësonin kushtet dhe kriteret e nenit 31 të Kodit Zgjedhor.

Menjëherë me emërimin e tyre, KQZ-ja me vendimin Nr.109, datë 2.3.2011 thirri mbledhjen e parë të KZAZ-ve. Me datën 4 dhe 5 Mars u bë konstituimi i të gjithë KZAZ-ve. Në këtë mënyrë KZAZ-të filluan së funksionuari normalisht dhe menjëherë filluan procedurat për ngritjen e infrastrukturës zgjedhore sipas zonave përkatëse dhe kryesisht për regjistrimin e kandidatëve dhe listave shumemërore të partive politike.

Partia Socialiste e Shqipërisë dhe Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut, kanë paraqitur propozimet për anëtarë të KZAZ-ve vetëm me datë 21.03.2011, pra gati dy muaj me vonesë. Megjithatë lista me propozimet e Partisë Socialiste nuk kishte dokumentacionin e duhur ligjor. Gjithashtu referuar nenit 29 pika 1, germa ç të Kodit Zgjedhor, Partia Socialiste e Shqipërisë nuk përmbushi detyrimin ligjor për të paraqitur 30% të listës me propozime për anëtarë të KZAZ-ve nga gjinia tjetër. Për këtë arsye, KQZ-ja me vendimin Nr.197, datë 29.03.2011 ia ktheu për plotësim listën me propozimet e saj Partisë Socialiste.

Gjatë procesit të regjistrimit të kandidatëve disa KZAZ, për shkak të mosnjohjes së Kodit Zgjedhor, rrjedhojë kjo e mosmarrjes pjesë në trajnimet e organizuara nga KQZ-ja refuzuan regjistrimin e disa subjekteve të caktuara zgjedhore në zona të caktuara.

Përgjithësisht KZAZ-të funksionuan normalisht, por pati dhe disa KZAZ të cilat paraqitën probleme në zbatimin e dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe vendimeve të KQZ-së.

Fenomen negativ i cili u përsërit dhe në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 8 Maj, ishte zëvendësimi i shumë anëtarëve të KZAZ-ve, edhe pasi ata kishin marrë trajnimin e nevojshëm nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

NIVELET E TRETA TË KOMISIONEVE ZGJEDHORE

Kodi Zgjedhor në nenin 36 të tij ka përcaktuar që Komisionet e Qendrave të Votimit, formohen sipas të njëjtës mënyrë siç ngrihen dhe KZAZ-të. Gjithashtu kjo dispozitë ka përcaktuar gjithashtu se partitë politike të cilat kanë të drejtë të kenë anëtarë të KQV-ve, duhet t'i dërgojnë propozimet e tyre pranë KZAZ-ve jo më vonë se 45 ditë nga data e zgjedhjeve. Këtë përcaktim ligjor nuk e zbatoi asnjë prej partive politike. Partitë politike dërguan propozimet e tyre për anëtarë të KQV-ve pas këtij afati ligjor dhe gjithashtu ato i ndryshuan serish listat me emrat e anëtarëve të propozuar për në KQV. Emërimi i tyre është bërë gjithashtu në kundërshtim me kërkesat e Kodit Zgjedhor vetëm dy apo tre ditë para datës së zgjedhjeve. Kjo praktikë e ndjekur në vazhdimësi nga partitë politike ka ndikuar negativisht në administrimin e procesit zgjedhor ditën e zgjedhjeve për shkak të njohurive të pakta që këta komisionerë kanë marrë për procesin zgjedhor megjithë

Adresa:
Pallati i Kongreseve,
Blvd. Dëshmoret e Kombit,
Tirane,

Tel./Fax:
+355 (4) 23 53 63

Website: www.ccc.org.al

E-mail:
infosec@ccc.org.al





insistimin e strukturave të KQZ-së për t'i trajnuar ato dhe përtej afateve të përcaktuara për këtë qëllim.

Të njëjtën praktikë partitë politike kanë ndjekur dhe me propozimet për anëtarë të grupeve të numërimit të votave, që do të thotë se anëtarët e GNV-ve janë emëruar jo në afatin e duhur ligjor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është asistuar nëpërmjet ekspertëve të huaj të kontraktuar nga OSCE-ja, Komisioni i Venecias dhe Këshilli i Europës në hartimin e manualeve të trajnimit për të gjitha nivelet e komisioneve (KZAZ, KQV GNV).

Si edhe në zgjedhjet e kaluara funksionimi i komisioneve zgjedhore të niveleve të dyta dhe të treta edhe në zgjedhjet vendore 2011 ka pasur problematikat e veta të cilat kanë vështirësuar administrimin e procesit zgjedhor. Këto problematika konsistojnë kryesisht në moszbatimin e detyrimit ligjor nga partitë politike për sjelljen e propozimeve për anëtarë të komisioneve të niveleve të ulta, në abuzimin me hapësirat që lë Kodi në lidhje me plotësimin e vakancave, në mosrespektimin e kritereve për përzgjedhjen dhe emërimin e këtyre anëtarëve, si dhe në mosrespektimin e detyrave nga ana e komisionerëve gjatë administrimit të procesit zgjedhor.

KQZ për zgjidhjen e disa prej këtyre problematikave ka bërë propozimet përkatëse pranë Komisionit Parlamentar të Reformës Zgjedhore sipas aneksit bashkëngjitur këtij raporti.

ZHVILLIMI I DITËS SË ZGJEDHJEVE

Procesi dhe dita e zgjedhjeve në tërësi ka qenë pa dyshim standardi më demokratik i realizuar, jo vetëm nga administrata zgjedhore por edhe nga qytetarët shqiptarë, të cilët treguan një interes dhe pjesëmarrje të dukshme në rritje ditën e zgjedhjeve. Më datë 8 Maj, zgjedhjet u zhvilluan normalisht në 382 njësi vendore nga 384. Vetëm në 2 komuna, apo 0.5% të njësisive vendore në rang vendi, zgjedhjet nuk u zhvilluan për arsye se:

- Në komunën Shllak, Qarku Shkodër, nuk u paraqitën komisionerët e qendrave të votimit, ndërsa
- Në komunën Pishaj, Qarku Elbasan, zgjedhjet nuk arritën të zhvilloheshin për arsye të një gabimi teknik në fletën e votimit. Për të njëjtën arsye, në komunën Mollas, Qarku Korçë, zgjedhjet u zhvilluan vetëm për kandidatët për Kryetar Komune.

Administrimi i problematikës së ditës së zgjedhjeve nga KQZ konsistoi vetëm në zgjidhjen e problemeve teknike që u identifikuan në disa njësi të largëta zgjedhore, kryesisht si rezultat i përplasjes me kushte të vështira të infrastrukturës në disa



raste dhe atyre atmosferike. Më konkretisht, u identifikua dëmtimi i kutive të votimit gjatë transportit në 5 QV, ose 0.1% të QV-ve në rang vendi, të cilat u zëvendësuan menjëherë. Gjithashtu, në 9 qendra votimi, apo 0.18% të QV-ve në rang vendi, u konstatua sasi më e vogël e fletëve të votimit sesa parashikimi, si rezultat i një gabimi njerëzor në paketimin e fletëve të votimit nga shtypshkronja. Këto raste u zgjidhën me konsensus dhe vendimmarrje të KZAZ-ve respektive, duke plotësuar numrin e nevojshëm të fletëve të votimit nga sasi të rezervë të qendrave të tjera, brenda së njëjtës njësi vendore. Çdo pretendim tjetër, kryesisht nga subjektet zgjedhore në lidhje me administrimin apo materialet zgjedhore të përdorura gjatë ditës së zgjedhjeve, është verifikuar rast pas rasti dhe ka rezultuar i pavërtetë.

Për sa i përket zbatimit të Kodit Zgjedhor, veçanërisht nga komisionet e qendrave të votimit, KQZ konstatoi se përgjithësisht anëtarët e KQV-ve kanë demonstruar profesionalizëm në ushtrimin e detyrës dhe i janë përgjigjur pozitivisht apelit të KQZ-së për të respektuar dhe zbatuar Kodin Zgjedhor dhe vetëm në 1 rast, në QV nr. 1992, të ZAZ 54 (Njësia Bashkiake nr. 10 në Tiranë), Komisioni i Qendrës së Votimit tentoi forcërisht që të mbyllë procesin e votimit para orës 19.00 edhe pse jashtë qendrës së votimit kishte mbi 100 votues që prisnin në radhë, duke shkelur kështu hapur Nenin 11, pika 2 dhe 3 të kodit Zgjedhor.

Përveç, administrimit të problematikës teknike dhe monitorimit të procesit në tërësi, KQZ, për herë të parë aplikoi me sukses informimin e publikut për pjesëmarrjen në votim, projekt ky i miratuar paraprakisht me vendim të KQZ-së. Në datën 8 Maj, çdo 3 orë duke filluar nga hapja e votimit, publiku u informua nga KQZ për pjesëmarrjen e zgjedhësve në votim në bazë qarku, bashkive kryesore dhe në rang vendi. Në bazë të infrastrukturës dhe skemës së ngritur, KZAZ-të kanë dërguar informacionin e kërkuar për qendrat e votimit për çdo njësi vendore. Ky informacion, është përpunuar në KQZ dhe dhënë si informacion për median, subjektet dhe publikun e interesuar.

Duhet nënvizuar fakti se shifrat e pjesëmarrjes në zgjedhje ditën e votimit, të krahasuara me shifrat zyrtare, në rang vendi janë pothuajse njësoj, përkatësisht 50.91 me 50.96 %, në rang qarku lëvizin me 3-4%. Në përfundim të votimit, KQZ për herë të parë përfshiu në këtë informim publik edhe të dhënat për pjesëmarrjen e femrave në votim që në rang vendi ishte 45.4%.

FUNKSIONIMI I INFRASTRUKTURËS TEKNIKE TË VNV-ve

Edhe në këto zgjedhje, numërimi i votave është bërë i përqendruar në 66 vende numërimi. Prefektët e Qarqeve, kanë vënë në dispozicion të procesit të numërimit të votave, të gjitha ambientet të cilat ishin të përshtatshme për t'u shfrytëzuar për

Adresa:
Pallati i Kongreseve,
Blvd. Dëshmoret e Kombit,
Tiranë,

Tel./Fax.
+355 (4) 23 53 63

Website: www.cec.org.al

E-mail
infosec@cec.org.al





këtë qëllim dhe ndodheshin brenda territorit të qarkut. Në përcaktimin e VNV-ve, KQZ i ka dhënë përparësi barazlargimit nga qendrat e votimit, sipërfaqes së shfrytëzueshme, vendndodhjes së objektit, sigurisë, kushteve fizike dhe infrastrukture për vendosjen e teknologjisë mbështetëse të numërimit të votave. Thuajse në të gjitha rastet, kur ka qenë e mundur janë shfrytëzuar të njëjtat ambiente si në zgjedhjet paraardhëse dhe vetëm në një rast, si VNV është shfrytëzuar një ambient privat, për të cilin është dhënë autorizim i posaçëm. Të gjitha ambientet e propozuara, janë inspektuar nga administrata e KQZ-së dhe është gjetur bashkëpunim shumë i mirë nga pushteti vendor për vënien e tyre në funksion. Të gjitha ambientet janë vënë në dispozicion të KZAZ-ve jo më vonë se 10 ditë para ditës së zgjedhjeve duke bërë kështu të mundur edhe instalimin e teknologjisë mbështetëse të numërimit të votave. Në përgatitjen e infrastrukturës së nevojshme logjistike të VNV-së, është shfrytëzuar plan-vendosja tip e miratuar me udhëzimin nr. 12, datë 21.04.2009 "Për caktimin dhe përgatitjen e vendit të numërimit të votave, mënyrën e ngritjes së grupeve të numërimit dhe caktimin e tavolinave të numërimit të votave".

Me miratimin e vendeve të numërimit të Votave, u përgatit dhe u sigurua infrastruktura e nevojshme logjistike për një mirëfunksionim të VNV-së gjatë procesit të numërimit të votave. Në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit mes KQZ-së dhe OSSH-së u bë i mundur sigurimi i pandërprerë i energjisë elektrike për të gjitha VNV-të. Gjithashtu, në bashkëpunim me Albtelecom-sh.a, u bë e mundur lidhja telefonike me të gjitha VNV-të.

Në bazë të përcaktimeve të Kodit Zgjedhor, KQZ me Vendimin nr. 46, datë 9.12.2010 miratoi përdorimin e kamerave regjistruese dhe monitorëve për vlerësimin e fletëve të votimit në VNV.

Qëllimi i këtij Vendimi ishte:

- të bënte të mundur shfaqjen e fletës së votimit për vëzhguesit,
- të regjistronte materialin e filmuar,
- të transmetonte të dhënat menjëherë në selinë e KQZ,
- të mbante nën kontroll të plotë dhe të vazhdueshëm, nga selia e KQZ, të 66 VNV në të gjithë Shqipërinë.

Për realizimin e këtij Vendimi u shfrytëzuan pajisjet e përdorura në Zgjedhjet e vitit 2009 dhe u përzgjedh një kompani për kryerjen e shërbimit. Kompania e përzgjedhur nën monitorimin e KQZ-së, me një plan të detajuar, filloi instalimin e pajisjeve në ambientet e VNV-ve. Para ditës së zgjedhjeve u bë testimi i sistemit të pajisjeve në çdo VNV dhe më pas testimi i lidhjes së gjithë VNV-ve me KQZ-në. Kjo bëri të mundur që sistemi të funksiononte normalisht në momentin e vlerësimit dhe

Adresa:
Pallati i Kongreseve,
Blvd. Dëshmoret e Kombit,
Tirane,

Tel./Fax:
+355 (4) 23 53 63

Website: www.ccc.org.al

E-mail:
infosec@ccc.org.al





numërimit të votave dhe mandej për nxjerrjen e rezultatit përmblendhës nga KZAZ-të.

PROCESI I NUMËRIMIT TË VOTAVE, TABULIMI DHE SHPALLJA E REZULTATEVE

Pas marrjes në dorëzim të bazës materiale zgjedhore KZAZ-të filluan procesin e numërimit të votave, mbështetur në Udhëzimin përkatës të KQZ-së, i përmirësuar mbi bazën e eksperiencës së zgjedhjeve të vitit 2009. Me gjithë përmirësimet në procesin e numërimit të votave, asnjë KZAZ nuk mundi të përfundojë numërimin për njësitë vendore të zonës, brenda afatit ligjor që është ora 17-00 e ditës pas zgjedhjeve. Në zgjedhjet vendore procesi i numërimit është më i ngarkuar në volum për faktin e njohur se votohet për dy pushtete, madje në bashkinë e Tiranës për katër. Rishikimi i madhësisë së zonave të administrimit zgjedhor ose i zgjatjes së kohës të procesit të numërimit, mendojmë se janë probleme që duhen diskutuar në procesin e reformës zgjedhore.

Numërimi i votave në rang ZAZ-je bëhet nga Grupet e Numërimit nën administrimin e KZAZ-së, të emëruar me vendim nga këto të fundit.

Gjatë procesit të numërimit të votave, kryesisht në njësitë zgjedhore Bashkia Tiranë dhe Njësitë Bashkiake të saj, në disa raste pati bllokime. KQZ për këto raste ndërhyri në mënyrë aktive kryesisht ose me kërkesë të subjekteve zgjedhore, duke marrë vendimet përkatëse për ecurinë normale dhe në përputhje me ligjin të procesit të numërimit. Gjatë procesit të numërimit të votave KQZ mori tetë vendime duke urdhëruar KZAZ-të, të vazhdonin procesin e numërimit: Ndërhyrja e KQZ bëri që procesi i numërimit të votave të vazhdonte ecurinë normale në KZAZ-nr. 49, KZAZ-në, nr. 52, KZAZ-në nr. 54, KZAZ-në nr. 63

Ndërhyrja e KQZ-së me vendimmarrje në këto raste u pranua nga të gjithë subjektet zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhje.

Nisur nga kërkesat e paraqitura nga 10 KZAZ-të e njëjësive bashkiake të Bashkisë Tiranë, dhe nga një subjekt zgjedhor, KQZ kryesisht në cilësinë e KZAZ-së së njësisë zgjedhore Bashkia Tiranë, në një fazë të rëndësishme të procesit zgjedhor sic është faza e numërimit të votave vendosi të kryejë vetë hapjen e 117 kutive të votimit të Zonës Zgjedhore Bashkia Tiranë (gjithsej 108 qendra votimi), duke numëruar dhe vlerësuar fletët e votimit të pavlerësuarra dhe të panumëruara për kryetarin, këshillin e bashkisë Tiranë, kryetarin e njësisë bashkiake dhe këshillin e njësisë bashkiake, të cilat aksidentalisht nuk janë hedhur në kutitë respektive të së njëjtës qendër votimi në zgjedhjet e Bashkisë Tiranë të datës 8 maj 2011. Ky investim i KQZ ishte jo vetëm në përbushje të detyrimit ligjor të zgjidhjes së paqartësive të shfaqura në organet e varësisë gjatë administrimit të procesit zgjedhor, por gjithashtu në respektim të garancisë kushtetuese: barazisë së votës.

Adresa:
Pallati i Kongreseve,
Blvd. Dëshmoret e Kombit,
Tirane,

Tel./Fax:
+355 (4) 23 53 63

Website: www.ccc.org.al

E-mail:
infosec@ccc.org.al





Konkretisht, u këqyrën, vlerësuan dhe numëruan votat e hedhura në kutinë e gabuar për 108 qendra votimi, respektivisht si më poshtë:

KZAZ nr. 46 – 15 QV

KZAZ nr. 47 – 10 QV

KZAZ nr. 48 – 12 QV

KZAZ nr. 49 – 21 QV

KZAZ nr. 50 – 8 QV

KZAZ nr. 51 – 5 QV

KZAZ nr. 52 – 14 QV

KZAZ nr. 53 – 14 QV

KZAZ nr. 55 – 11 QV

Vendimi i KQZ-së në lidhje me numërimin dhe vlerësimin e fletëve të votimit të pavlerësuar dhe të panumëruara për kryetarin, këshillin e bashkisë Tiranë, kryetarin e njësisë bashkiake dhe këshillin e njësisë bashkiake, të cilat aksidentalisht nuk janë hedhur në kutitë respektive të së njëjtës qendër votimi në zgjedhjet e Bashkisë Tiranë të datës 8 maj 2011, u ankimua në Kolegjin Zgjedhor, i cili vlerësoi si vendim në përputhje me ligjin dhe e la në fuqi.

Duke bërë një analizë post procesit të vlerësimit të fletëve të votimit të hedhura në kutitë e gabuara KQZ konstaton se nisur nga shqetësimi i lindur në Bashkinë e Tiranës për fletët e votimit të hedhura në kutitë e gabuara, u hapën dhe vlerësuan këto vota, sipas informacioneve të marra nga KZAZ-të, fillimisht në kuti të 117 QV-ve dhe më vonë, pas urdhërimit nga Kolegji Zgjedhor, edhe në pjesën tjetër të kutive që nuk ishin vlerësuar. Në gjithë këtë proces vlerësimi pati ndryshim të shifrave të pasqyruara më parë në tabelat e rezultateve të plotësuar nga GN-të dhe si pasojë edhe në tabelat përmbledhëse të rezultateve të plotësuar nga KZAZ-të. KQZ në tabelat e lartpërmenduar nuk bëri ndryshim në numrin e fletëve të votimit të gjetura në kuti, kuptohet as të numrit të zgjedhësve që kanë votuar. Gjatë këtij vlerësimi, duke qenë se votat e hedhura në kutitë e gabuara ishin vlerësuar si të pavlefshme nga GN, KQZ pakësoi numrin e votave të pavlefshme në kutinë ku ato u gjetën dhe rriti numrin e votave të vlefshme, për aq sa u vlerësuan të tilla, në kutinë që ato i përkisnin. Në këtë kuptim ndryshoi "balaca" që ishte më parë midis fletëve të votimit të gjetura në kuti dhe shumës së votave të vlefshme me ato të pavlefshme në kutinë e llojit përkatës dhe rrjedhimisht në tabelën përmbledhëse të atij "pushteti". Në këto kushte për të parë rregullsinë e procesit duhet parë ruajtja e "balancës" në të katër kutitë (pushtetet) e marra së bashku. Pra, duhet parë shuma e votave të vlefshme me ato të pavlefshme për të katër kutitë, si ishte në fillim të këtij procesi dhe si është në fund të tij.

Nga analiza e bërë me këtë logjikë, duke u mbështetur në shifrat e tabelave të rezultateve tashmë të zyrtarizuara, duke riparë e duke analizuar të gjithë dokumentacionin që përdori KQZ në këtë proces, duke marrë parasysh gabimet

Adresa:
Pallati i Kongreseve,
Blvd. Dëshmoret e Kombit,
Tirane,

Tel./Fax:
+355 (4) 23 53 63

Website: www.ccc.org.al

E-mail:
infosec@ccc.org.al





njerëzore tashmë të identifikuar plotësisht, del se në të katër kutitë e 485 QV-ve të bashkisë Tiranë, si në momentin e ardhjes së tyre në KQZ dhe në fund të proceseve të vlerësimit të bëra nga KQZ, janë sasi e njëjtë fletësh votimi, gjithsej 1 milion 26 mijë e 27 copë.

Si edhe në zgjedhjet e vitit 2009, procesi i numërimit të votave dhe rezultati u transmetua elektronikisht nga VNV-të në KQZ dhe u informua në dinamik publiku si nëpërmjet mediave dhe nga faqe e KQZ-së në internet. Në përfundim të numërimit të votave për çdo njësi të qeverisjes vendore nga ana e KZAZ-ve nxirrej tabela përmbledhëse e rezultatit si për kryetar dhe për këshillin, e pasi miratohej me vendim nga KZAZ-ja, shpallej duke e shpërndarë subjekteve që përcakton Kodi Zgjedhor. Në bazë të Udhëzimit të KQZ-së, për të ndihmuar KZAZ-të, Tabela Përmbledhëse e Rezultatit printohet nga baza e të dhënave. Për 172 njësi vendore ose rreth 45 përqind të tyre, KZAZ-të e printuan këtë tabelë nga baza e të dhënave, të tjerat e plotësuan me dorë, mbështetur në variantin përkatës të Udhëzimit të KQZ-së. Problem pati me tabelat përmbledhëse të rezultatit për këshillin e atyre njësive, që nga KZAZ-të u plotësuan me dorë, por nuk bënë shumatoren e votave të fituara nga subjektet garuese. Tabela të tilla ishin për 141 njësi vendore ose për rreth 37 përqind të tyre.

Kryetarët fitues të njësive vendore u shpallën me vendim nga KZAZ-të përkatëse, ndërsa mandatet për këshillin për çdo njësi vendore si dhe këshilltarët e zgjedhur sipas listave shumemërore të subjekteve garuese, në bazë të përcaktimeve që bënë Kodi Zgjedhor, u miratuan dhe u shpallën nga KQZ, ndryshe nga më parë që bëheshin nga KZAZ-të. Në bazë të nenit 123 të Kodit Zgjedhor tabela përmbledhëse e rezultatit si për kryetarin dhe për këshillin e bashkisë Tiranë u hartua dhe u miratua nga KQZ.

Për 384 postet për kryetarë njësie vendore, përfshi dhe 11 njësitë bashkiake të Tiranës, garuan 872 kandidatë, nga të cilat 15 ose 1.72 përqind ishin femra. Ndër kandidatët fitues për kryetar, 5 ose 1.31 përqind ishin femra. Në listat shumemërore për këshilltarë të paraqitura nga 54 parti politike në të gjitha njësitë vendore, ishin gjithsej 74739 kandidatë, nga të cilat 22604 ose 30.2 përqind femra. KQZ me vendimet përkatëse miratoi shpërndarjen e 6152 mandateve për të 384 njësitë vendore, duke nominuar dhe këshilltarët fitues nga listat shumemërore të 49 partive që arritën të fitonin të paktën një mandat në këshill. Këshilltare femra u zgjedhën gjithsej 760 ose 12.4 përqind. Këshilltarë të propozuar nga zgjedhësit u zgjedhën 18 nga 62 që garuan në të gjitha njësitë vendore.

PROCESI ANKIMOR

Në fazën para datës së zgjedhjeve në KQZ u paraqitën nga subjektet zgjedhore gjithsej 58 kërkesa ankimore. Kërkesat ankimore kryesisht janë paraqitur nga

Adresa:
Pallati i Kongreseve,
Blvd. Dëshmoret e Kombit,
Tirane,

Tel./Fax:
+355 (4) 23 53 63

Website: www.cec.org.al

E-mail:
infosec@cec.org.al





kandidatë të mbështetur nga zgjedhësit kundër vendimeve të KZAZ-ve për mosregjistrimin e tyre si kandidat.

Kundër vendimeve të KQZ për shqyrtimin e kërkesave ankimore janë paraqitur në kolegjin zgjedhor gjithsej 33 kërkesa. Në 24 raste Kolegji Zgjedhor ka vlerësuar vendimet e KQZ në përputhje me ligjin dhe i ka lënë ato në fuqi. Në 9 raste Kolegji Zgjedhor ka vendosur pranimin e kërkesë padisë dhe ndryshimin e vendimit të KQZ.

Subjektet zgjedhore kanë bërë ankim në Kolegjin Zgjedhor edhe kundër vendimeve të KQZ, të cilat kanë patur si qëllim rregullimin e aspekteve të administrimit zgjedhor, për të parandaluar fenomene negative që mund të cenonin procesin zgjedhor. Në këto raste Kolegji Zgjedhor ka vlerësuar në përputhje me ligjin këto vendime dhe i ka lënë në fuqi.

Në fazën pas datës së zgjedhjeve në KQZ janë paraqitur gjithsej 108 kërkesa ankimore. Objekt i ankimeve ka qenë kryesisht:

- Kundërshtimi i vendimeve të KZAZ-ve në lidhje me rezultatin për kryetar dhe për këshill.
- kërkesa për pavlefshmëri të zgjedhjeve në disa njësi zgjedhore.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, gjatë shqyrtimit në rrugë administrative të ankimeve ndaj vendimeve të KZAZ-ve, por dhe në zbatim të urdhërimeve të Kolegjit Zgjedhor, ka proceduar duke kryer sipas rastit këqyrjen e materialit zgjedhor dhe/ose kutitë e votimit, fletët e votimit për kryetar apo këshill të qeverisjes vendore për 14 komuna gjithsej 40 kuti votimi dhe për 2 bashki gjithsej 3 kuti votimi. Vetëm për bashkinë Tiranë, si pasojë e ankimeve zgjedhore dhe zbatimit të vendimit të Kolegjit Zgjedhor, KQZ hapi dhe këqyri 1793, kuti votimi.

Kundër vendimeve të KQZ për shqyrtimin e kërkesave ankimore janë paraqitur në Kolegjin Zgjedhor gjithsej 57 kërkesa. Në 43 raste Kolegji Zgjedhor ka vlerësuar vendimet e KQZ në përputhje me ligjin dhe i ka lënë ato në fuqi. Në 14 raste Kolegji Zgjedhor ka vendosur pranimin e kërkesë padisë.

Procesi ankimor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore pas datës 8 maj 2011, kryesisht për Bashkinë e Tiranës, ishte një proces i gjatë, i cili kërkoi energji, vullnet dhe profesionalizëm nga KQZ dhe administrata e saj.

TRANSPARENCA ZGJEDHORE

Në gjithë veprimtarinë dhe vendimmarrjen e KQZ-së, transparenca ka qenë dhe mbetet një ndër synimet kryesore. Kjo, jo vetëm për arsye të detyrimit që buron nga neni 22, i Kodit Zgjedhor ku përcaktohet qartë se "Mbledhjet e KQZ-së janë

Adresa:
Pallati i Kongreseve,
Blvd. Dëshmoret e Kombit,
Tiranë,

Tel./Fax:
+355 (4) 23 53 63

Website: www.cec.org.al

E-mail:
infosec@cec.org.al





kurdoherë publike", por mbi të gjitha, për të garantuar të gjithë shtetasit shqiptarë dhe subjektet politike se, e gjithë veprimtaria e KQZ-së, për organizimin, zhvillimin dhe certifikimin e zgjedhjeve mbetet një ndër procedurat më transparente në Republikën e Shqipërisë.

Ky fakt, nuk mbetet thjesht një konstatim institucional, por vihet në dukje dhe nga Misioni Ndërkombëtar i Vëzhgimit të ODIHR, i cili ndër të tjera, në raportin e tij paraprak të datës 10 maj konstaton:

-Zgjedhjet vendore të vitit 2011 janë vlerësuar për përputhshmërinë e tyre me angazhimet e OSBE-së dhe Këshillit të Europës për zgjedhje demokratike, si edhe me legjislacionin shqiptar.

-Zgjedhjet e 8 majit 2011 për qeverisjen vendore në Republikën e Shqipërisë ishin konkurruese dhe transparente.

-KQZ-ja, në përgjithësi, u tregua transparente gjatë procesit të vendimmarrjes. Seancat ishin publike dhe transmetoheshin drejtpërdrejt në faqen e saj të internetit.

Për të realizuar këtë qëllim madhor KQZ, që nga zgjedhjet e përgjithshme të 2009, e në vijim, transmeton në kohë reale zhvillimin e çdo mbledhje të saj nëpërmjet faqes së internetit, me kapacitete të mëdha teknike, duke mundur kështu ndjekjen e tyre nga çdo cep i botës. Ky fakt ka krijuar të gjithë hapësirën që jo vetëm subjektet politike, masmedia, por edhe çdo qytetar i thjeshtë të ndjekë të gjithë punën dhe procedurat e institucionit për organizimin, zhvillimin dhe certifikimin e rezultatit të zgjedhjeve.

Për më tepër, prej vitesh KQZ ka vendosur një bashkëpunim shumë të mirë me masmedian shqiptarë, duke u krijuar të gjitha kushtet dhe hapësirat e nevojshme për të transmetuar 'live' çdo seancë pune të KQZ-së, por edhe çdo hap të procesit për të cilën ata kanë qenë të interesuar si: punën e KZAZ-ve, ecurinë e procesit në ditën e votimit, por edhe procesin e numërimit deri në përmbyllje të tij, në çdo zonë zgjedhore. Transmetimi 'live' i procesit të numërimit për Bashkinë e Tiranës, dhe jo vetëm, në zgjedhjet vendore të 8 majit është shembulli më evident për këtë fakt.

Në faqen zyrtare të internetit të KQZ-së publiku i gjerë mund të gjejë të gjitha vendimet apo udhëzimet e marra nga KQZ, në format elektronike apo dhe të mësojë në kohë reale rezultatit të zgjedhjeve që publikohet aty hap pas hapi.

Prezenca e kamerave dhe gazetarëve në proces i ka shërbyer jo vetëm rritjes maksimale të transparencës, por në të njëjtën kohë është një ndihmë e çmuar në mbarëvajtjen e punës, pasi jo në pak raste, si rezultat i raportimeve mediatike, KQZ është njohur me problematika të ndryshme të krijuar në terren dhe pas verifikimit ka marrë masa të menjëherëshme për zgjidhjen e tyre.

Adresa:
Pallati i Kongreseve,
Blvd. Dëshmoret e Kombit,
Tirane,

Tel./Fax:
+355 (4) 23 53 63

Website: www.cec.org.al

E-mail:
infosec@cec.org.al





Por sigurisht që elementët e cilësuar më sipër janë tregues në funksion të rritjes së transparencës, pasi në thelb, garanti kryesor i transparencës në çdo raund zgjedhor mbetet kuadri ligjor, mënyra e funksionimit të KQZ-së, komisioneve të niveleve të dyta, të treta dhe grupeve të numërimit, procedurat e numërimit të plotësuar me kamera dhe monitorë nga mund të monitorosh çdo fletë votimi, masat e larta të sigurisë që shoqërojnë gjithë procesin, që nga prodhimi i fletës së votimit, vulat e sigurisë dhe përpilimi i procesverbaleve të disponueshme nga të gjithë palët në proces, duke garantuar transparencë, siguri maksimale dhe patjetërsueshmërinë e rezultatit.

PËRSËRITJA E ZGJEDHJEVE

Procesi zgjedhor i datës 31.07.2011 është zhvilluar në 9 zona zgjedhore, nga 10 të tilla, që ishte vendosur përsëritja e zgjedhjeve. Në Komunën Shalë, Qarku Shkodër nuk u zhvilluan zgjedhjet.

Në zonat zgjedhore në të cilat u zhvilluan zgjedhjet, procesi në përgjithësi u zhvillua normalisht dhe pa probleme. Në dy qendra votimi, procesi i votimit filloi me pak vonesë dhe konkretisht në QV-në Nr. 0130 në Komunën Shllak, Qarku Shkodër dhe në QV-në Nr. 4628 Komuna Finiq, Qarku Vlorë.

Të gjithë qendrat e tjera të votimit janë hapur në rregull, është zhvilluar procesi i votimit në rregull dhe po ashtu janë mbyllur në rregull pa asnjë problem. Gjithashtu të gjithë kutitë e votimit dhe kutitë e materialeve zgjedhore janë marrë në dorëzim si të rregullta pranë çdo KZAZ-je. Procesi i numërimit gjithashtu është zhvilluar normalisht në të gjitha këto zona zgjedhore dhe KZAZ-të kanë plotësuar tabelat e rezultateve dhe kanë miratuar me vendim të gjithë tabelat përmbledhëse.

Për sa i përket zgjedhjeve për Kryetar të komunës Shalë, Qarku Shkodër (ZAZ-42), është me vend që të theksojmë se ky proces është zvarritur artificialisht, duke e detyruar KQZ-në që të organizojë zgjedhjet në këtë Komunë 3 herë, respektivisht në datat (8 Maj, 31 Korrik dhe 21 Gusht 2011) dhe realizimit me shumë vështirësi të zgjedhjeve në këtë Komunë. Madje KQZ ka qene e detyruar t'i kërkojë Policisë së Shtetit masa sigurie shtesë për administratën e saj dhe gjithë materialin zgjedhor të përdorur për këtë proces zgjedhor. Zgjedhjet në këtë Komunë u arritën të zhvilloheshin vetëm në datën 21 gusht 2011, datë në të cilën u përmyll edhe zhvillimi i zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 8 Maj 2011.

BUXHETI I KQZ-SË PËR VITIN 2011

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve si institucion i pavarur financohet nga Buxheti i Shtetit. Buxheti i KQZ-së përbën zë më vete në Buxhetin e Shtetit. Sipas përcaktimeve të Kodit Zgjedhor, neni 86 pika 2 dhe 3, përveç fondeve për





funksionimin e institucionit, Kuvendi vuri në dispozicion të KQZ-së fonde për përgatitjen, zhvillimin, mbikëqyrjen dhe çdo aspekt tjetër të procesit zgjedhor.

Për vitin 2011, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është financuar nga buxheti i shtetit në funksion të realizimit të detyrimeve ligjore të institucionit, në shumën 100.2 milion lekë, i detajuar sipas klasifikimit buxhetor si vijon:

a. Shpenzime për pagat e administratës	68.2 milion lekë
b. Kontributi i Sigurimeve Shoqërore	8 milion lekë
C. Shpenzime për Mallra dhe Shërbime	21 milion lekë
d. Shpenzime për investime	3 milion lekë

Totali: 100.2 milion lekë

Duke analizuar strukturën buxhetore të institucionit rezulton se 76 % të fondeve janë akorduar për mbulimin e shpenzimeve për paga dhe kontribut të sigurimeve shoqërore, 20 % të fondeve është akorduar për shpenzime për mallra dhe shërbime dhe 4 % të fondit për investime.

Kodi Zgjedhor, në nenin 182, pika 2, përcakton se anëtarit të KQZ-së që i ndërpritet mandati për shkak të këtij Kodi, përfiton pagën e funksionit deri në përfundimin e mandatit, sipas të cilit është zgjedhur, por jo më shumë se tre vjet. Buxheti i KQZ-së për vitin 2011, përfshin edhe fondin për pagesën e këtyre anëtarëve.

Menaxhimi i fondeve të akorduara për institucionin është realizuar me korrektësi sipas zërave të shpenzimeve, dhe efektivitet duke treguar kujdes që fondet e miratuara të shpenzohen në kohën e duhur dhe me një administrim ekonomik efektiv.

Realizimi i buxhetit të institucionit për vitin 2011 paraqitet si vijon:

a. Shpenzime për pagat e administratës	61.3 milion lekë
b. Kontributi i Sigurimeve Shoqërore	7.4 milion lekë
C. Shpenzime për Mallra dhe Shërbime	21 milion lekë
d. Shpenzime për investime	2.6 milion lekë

Totali: 92.3 milion lekë

Realizimi i buxhetit kundrejt planit është bërë në masën 92 %, pra nga 100.2 milion të akorduara në 92.3 milion të realizuara. Fondet e mbetura pa përdorur janë 8 milion në zërin paga dhe kontribute për shkak të mospërdorimit të fondit të veçantë.

BUXHETI I ZGJEDHJEVE VENDORE 2011

Me ligjin nr.10355, datë 02.12.2010 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2011", Komisionit Qendror të Zgjedhjeve iu akordua një fond prej 600 milion lekësh për zhvillimin e zgjedhjeve për Organet e Qeverisjes Vendore 2011.





Kodi Zgjedhor, parashikonte risi edhe sa i përket infrastrukturës që do të përdorej për zgjedhje, realizimi i së cilave përkonte me një kosto financiare më të madhe nga ajo e parashikuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me Vendimin nr.41, datë 25.11.2010 "Për miratimin e strukturës së shpenzimeve buxhetore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 8 maj 2011" miratoi projektbuxhetin për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore 2011, duke parashikuar një strukturë buxhetore në shumën totale prej 750 milion lekë, (nr.zgjedhësve 3.165.054) me kosto për një votues rreth 1.7 euro.

KQZ-ja e motivuar për ruajtjen dhe përmirësimin e standarteve zgjedhore, eliminimin e të gjitha dobësive potenciale që mund të shkaktohen gjatë një procesi zgjedhor për shkaqe ekonomiko-financiare, kërkoi shtesë fondi në programin e zgjedhjeve, shtesë e cila u miratua me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 323, datë 29.04.2011 në shumën 65 milion lekë.

Duke analizuar strukturën buxhetore të zgjedhjeve të përgjithshme rezulton se 6 % të fondeve janë akorduar për mbulimin e shpenzimeve për paga dhe kontribut të sigurimeve shoqërore të personelit të përkohshëm, 31 % e fondit është akorduar për pagesën e komisionerëve të të gjitha niveleve, 61.4 % të fondeve është akorduar për shpenzime për mallra dhe shërbime dhe 1.6 % të fondit për investime.

Fondet e vena në dispozicion nga buxheti i shtetit u përdorën me efikasitet në përputhje me legjislacion në fuqi për manaxhimin e fondeve publike. Nga 665 milion lekë të akorduara u relaizuan 651 milion lekë ose 98%. Diferenca prej 14 milion lekësh konsiston në realizimin e fondit të parashikuar për pagesën e ekspertëve të emeruar për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për zgjedhjet vendore 2011. Kjo për faktin se dorëzimi i raporteve u bë në fillim të vitit 2012, në përputhje me vendimin e KQZ-së. Pjesa tjetër e fondeve të papërdorura konsiston në shpenzime për transport të bazës materiale dhe shpenzime për ambiente me qera në KZAZ për qëllime trajnimi.

FINANCIMI I SUBJEKTEVE ZGJEDHORE DHE AUDITIMI I FONDEVE TË PËRFITUARA DHE TË PËRDORURA NGA SUBJEKTET ZGJEDHORE

Fondi i dhënë nga buxheti i shtetit për financimin e partive politike për zhvillimin e fushatës zgjedhore në shumën 65 milione lekë u shpërnda nga KQZ para zgjedhjeve sipas përcaktimeve të nenit 87 të Kodit Zgjedhor.

Kështu me vendimin nr.434, date 16.04.2011, KQZ vendosi shpërndarjen e fondit të venë në dispozicion nga buxheti i shtetit midis partive politike si më poshtë:

1. Partia Demokratike	30.991.997 lekë
2. Partia Socialiste e Shqiperisë	30.547.726 lekë
3. Lëvizja Socialiste për Integrim	2.763.848 lekë
4. Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet	232.143 lekë





- | | |
|---|--------------|
| 5. Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut | 232.143 lekë |
| 6. Partia Republikane | 231.143 lekë |

Pas miratimit të rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, KQZ me vendim duhet të bëjë rishpërndarjen e fondeve që duhet të kthejnë partitë politike që nuk fituan mandate në Zgjedhjet Vendore. Me daljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve rezultoi se të gjitha partitë që kanë përfituar fonde publike për fushatën zgjedhore 2011, kanë fituar mandate, gjë që nuk i detyron ato të kthejnë fondet e përfituara nga buxheti i shtetit.

Procesi i auditimit të fondeve të përfituara dhe të përdorura nga subjektet politike gjatë fushatës elektorale, fillon me daljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve vendore të datës 8 maj 2011. Në mbështetje të nenit 91, të Kodit Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr.1232, datë 07.11.2011 emëroi me short 23 ekspertë kontabël të licensuar për auditimin e 161 subjekteve zgjedhore, nga të cilat:

- 55 parti politike
- 62 kandidatë për këshillat e propozuar nga zgjedhësit
- 44 kandidatë për kryetarë të propozuar nga zgjedhësit

Bazuar në vendimin e mësipërm KQZ ka lidhur kontratat me secilin nga ekspertët e licensuar, të cilët kanë audituar dhe dorëzuar pothuajse tërësisht raportet për subjektet e audituara. Këto raporte po shqyrtohen nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe për të gjithë ato subjekte që nuk kanë zbatuar dispozitat e Kodit Zgjedhor në lidhje me përfitimin dhe përdorimin e fondeve të fushatës do të zbatohen sanksionet e parashikuara në nenin 173 të Kodit Zgjedhor.

HAPJA E KUTIVE TË VOTIMIT DHE KUTIVE TË MATERIALEVE ZGJEDHORE, TË PËRDORURA NË ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, TË DATËS 8 MAJ 2011

Pas shpalljes me Vendim nr. 1229, datë 15.09.2011 të rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 8 Maj 2011 dhe përfundimit të afateve të ankimit, KQZ ka detyrimin ligjor që të realizojë procesin e hapjes së kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore, si dhe seleksionimin e dokumentacionit dhe materialit zgjedhor të gjetur brenda tyre.

Në zbatim të këtij detyrimi dhe përcaktimeve të nenit 178 të Kodit Zgjedhor, KQZ miratoi me vendim nr. 1230, datë 26.09.2011 "Për hapjen e kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore të përdorura në zgjedhjet e datës 8 Maj 2011". Ky proces u parashikua dhe realizua për një periudhë 2 mujore, gjatë së cilës u hapën dhe rehabilituan të gjitha kutitë e përdorura për zgjedhjet e datës 8 Maj 2011 dhe ato të përdorura për zgjedhjet e përsëritura. Për realizimin e këtij procesi, u ngrit



edhe Komisioni për hapje e Kutive të votimit (KHKV), përbërja dhe detyrat e të cilit janë të përcaktuara në Udhëzimin nr. 1, datë 30.01.2006 të KQZ-së.

Për sa i përket administrimit të dokumentacionit të gjetur brenda kutive, KQZ është gjendur gjithmonë përballë problematikës së terminologjisë së përdorur në nenin 178, nen i cili ka ndryshuar vetëm numrin që prej vitit 1991, ndërkohë që praktika zgjedhore në lidhje me dokumentacionin e përdorur ka ndryshuar plotësisht gjatë këtyre 20 viteve!

Pavarësisht nga ky fenomen, në përfundim të këtij procesi është dorëzuar në KQZ raporti me gjithë materialet dhe dokumentacionin e gjetur seleksionuar, organizuar dhe më pas i regjistruar në një bazë të dhënash. Ndërkohë, është bërë edhe komunikimi zyrtar me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivit të Shtetit për të filluar procedurat e dorëzimit të dokumentacionit.

Në procesin e pastrimit të kutive dhe sistemimit të dokumentacionit ne evidentojmë se mund ta lehtësojmë dhe përmirësojmë këtë proces, ndryshimi i dispozitës 178 të Kodit Zgjedhor në procedurën e asgjësimit të fletëve të votimit dhe kundërfletëve. Ndryshimi i dispozitës duhet të bëhet me qëllim përputhjen me normat e përcaktuara në Ligjin 9010, datë 13.02.2003 "Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta" dhe t'i përshtatet mundësive teknologjike të riciklimit të fletëve të votimit dhe kundërfletëve.

Adresa:
Pallati i Kongreseve,
Blvd. Dëshmoret e Kombit,
Tirane,

Tel./Fax.
+355 (4) 23 53 63

Website: www.cec.org.al

E-mail
infosec@cec.org.al



Ky dokument ka për qëllim që të kontribuojë në dhënien e një mendimi teknik mbi përmirësimet që duhet të bëhen në Kodin Zgjedhor, në mënyrë që praktika e administrimit zgjedhor të shmangë në maksimum problematika të cilat lidhen me hapësira dhe përcaktime jo-koherente të Kodit Zgjedhor, të cilat ndikojnë drejtpërsëdrejti në standardet që KQZ duhet të realizojë në mirë administrimin e një procesi zgjedhor. Theksojmë, se ky dokument bazohet kryesisht në praktikën dhe gjetjet e 2 proceseve të fundit zgjedhore.

I. ZONAT E ADMINISTRIMIT TË ZGJEDHJEVE

Për arsye të përshpejtimit të procedurave të numërimit të votave dhe realizimit të këtij procesi në afatet e Kodit, duhet të shtohet numri i zonave të administrimit zgjedhor (ZAZ-ve). Në këtë rast, ndryshimet që propozohen në nenin 27 janë:

- Që një rreth të mund të ndahet në më shumë se një ZAZ, numri i zgjedhësve nga më shumë se 70 mijë zgjedhës, të ndryshohet në më shumë se 60 mijë;
- Një bashki të jetë ZAZ më vete kur ka më shumë se 30 mijë zgjedhës; dhe
- Që një bashki të ndahet në dy ZAZ, duhet që numri i zgjedhësve të jetë më shumë se 80 mijë zgjedhës.

Ndryshimi i këtyre kritereve bën të mundur krijimin e 100 ZAZ-ve nga 66 që u krijuan në zgjedhjet e vitit 2009 dhe 2011.

II. ZONA DHE NUMRI I QV-VE

Menyra e trajtimit të shpërndarjes së votuesve në qendrat e votimit dhe përcaktimi i vendndodhjes së tyre (përveç përcaktimit të vendndodhjes së QV-ve në ambiente private), sipas Kodit Zgjedhor e përjashton përgjegjësinë e KQZ-së për këtë proces. Këtë kompetencë e ka Kryetari i njësisë së Qeverisjes Vendore.

Nisur nga Praktika e deritanishme, në shumë raste kryetarët në detyrë të organit të njësisë së qeverisjes vendore janë njëkohësisht dhe kandidatë për kryetar në zgjedhjet e ardhshme. Në këtë moment vendimarrja e tyre për shpërndarjen e votuesve në qendrat e votimit dhe caktimi i vendndodhjes së tyre është e diskutueshme, gjë e cila solli disa ankime nga subjektet zgjedhore, në KQZ-së në lidhje me këto vendime të kryetarëve të njësive vendore.

Kësaj problematike i shtohet edhe fakti që Kodi Zgjedhor nuk parashikon detyrimin për kryetarët e njësive të qeverisjes vendore për të dërguar në KQZ informacionin në lidhje me përcaktimin e QV-ve dhe numrin e zgjedhësve për çdo QV duke cuar në neglizhencën e kryetarëve të njësive vendore për të sjellë në kohë në KQZ këtë informacion të domosdoshëm për krijimin dhe funksionimin e QV-ve.

Për të zgjidhur këto problematika ne propozojme që Kodi Zgjedhor të rishikohet në mënyrë të tillë që kryetari i njësisë së qeverisjes vendore të kryejë procedurat e parashikuara në nenin 62, pika 1, gërma a dhe b të Kodit Zgjedhore dhe më pas t'ja propozoj KQZ-së për miratim.

Në këtë kontekst duhet që edhe afati i fundit për ndryshimin e vendndodhjes së qv-ve, të ndryshojë nga 10 në 20 ditë.

III. PËRGATITJA E FLETËS SË VOTIMIT

Hartimi dhe prodhimi i Fletës së Votimit është produkt i disa proceseve të tjera si:

- Regjistrimi i partive politike/koalicioneve;
- Regjistrimi i kandidatëve (listat shumëemërore, kryetarët për organet e qeverisjes vendore);
- Miratimi i listës përfundimtare nga kryetari i njësisë vendore dhe i dhënies së informacionit në KQZ

Për më tepër, afateve të parashikuara nga Kodi për këto procedura i shtohen edhe afatet e procedurave ankimore, duke e cuar afatin për prodhimin e fletëve të votimit deri në limitet e pamundësisë së realizimit. Në zgjedhjet e fundit vendore, KQZ në disa raste sporadike nuk pati as mundësinë kohore për të korrigjuar disa gabime teknike në fletën e votimit (fakt i vënë në dukje dhe nga raporti i OSBE/ODIHR).

Sugjerohet, që të gjitha afatet e sipërpërmendura, që ndikojnë në miratimin dhe prodhimin e fletës së votimit, duhet të largohen respektivisht edhe 30 ditë nga afati kohor i parashikuar në Kodin aktual.

Për sa i përket përmbajtjes së Fletës së Votimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, Kodi duhet të shprehet për përmbajtjen e fletës së votimit për kandidatët për kryetar të njësisë vendore dhe për renditjen midis partive dhe koalicioneve.

IV. DOKUMENTACIONI PËR PROCEDURAT E HAPJES/MBYLLJES SË VOTIMIT

Mënyra sesi Kodi Zgjedhor ka renditur procedurat dhe dokumentacionin përkatës për veprimet që KQV duhet të kryej gjatë gjithë veprimtarisë së saj është bazuar me të drejtë në qëllimin për të identifikuar çdo veprim të njëpasnjëshëm të KQV-së, duke lënë gjurmë të dokumentuar për këto veprime.

Nga vëzhgimi i deritanishëm i mënyrës së administrimit të këtij dokumentacioni, kemi vënë re se në shumicën dërrmuese, disa elementë nuk merren fare në konsideratë dhe nuk vlerësohen si veprime të rëndësishme që lidhen me sekretimin e procesverbalit të hapjes dhe mbylljes së votimit, pasi janë jashtëzakonisht të rralla rastet që këto procesverbale janë gjetur të sekretuara në zarfet përkatës. Për më tepër, përgjithësisht, komisionerët ankohen për numrin e madh të procesverbaleve dhe pamundësinë e ndjekjes së të gjithë procedurave për shkak të tensionit apo kohës së kufizuar në dispozicion. Me një panoramë të tillë, ku Kodi dokumenton në detaje veprimet e KQV-së, por që nga ana tjetër ato nuk gjen plotësisht zbatim në praktikë, atëherë qëllimi i ligjvënësit për të patur në çdo rast gjurmë të veprimeve në rast të hetimi, nuk realizohet!

Në këtë rast mendojmë që puna e KQV-së të përmblihet në një dokument të vetëm original – Libri i Protokollit – i cili duhet të përmbajë të gjithë procesverbalet tip që përcakton Kodi aktualisht dhe kopjet e karbonit të vulosura të tyre të futen detyrimisht në kutitë respektive, por origjinali i procesverbaleve duhet të jetë pjesë e pandarë e Librit të Protokollit.

Në pamje të parë, kjo praktikë duket sikur parimisht kufizon të drejtën e subjekteve të interesuar për të marrë kopje të këtij dokumentacioni (kryesisht procesverbalit të hapjes/mbylljes së votimit), por praktikisht, nuk ka asnjë rast të vetëm kur subjekte të jenë interesuar për kopje të këtij dokumentacioni dhe faktikisht, qëllimi i përdorimit të tyre plotësohet pasi veprimet janë të faktuara si në Librin e Protokollit ashtu edhe brenda kutive.

V. RUAJTJA E DOKUMENTACIONIT

Nisur nga debati i gjatë për hapjen e kutive të votimit të përdorura në zgjedhjet për kuvend 2009, u vu re se përmbajtja e dispozitës për ruajtjen e dokumentacionit, konkretisht neni 178, nuk ka ndryshuar që nga ligji për zgjedhjet e vitit 1991, ndërkohë që praktika zgjedhore në këto 20 vjet ka ndryshuar rrënjësisht. Për rrjedhojë, terminologjia dhe kërkesat e këtij neni nuk i korrespondojnë një pjese të konsiderueshme terminologjisë dhe dokumentacionit që përdoret për administrimin e procesit zgjedhor, e përcaktuar kjo nga ky Kod Zgjedhor!

Për më tepër, ajo që është një domosdoshmëri imediate për ndryshim në këtë dispozitë është procedura e asgjësimit të fletëve të votimit dhe kundërfletëve, e cila duhet të jetë në përputhje me normat e përcaktuara në Ligjin 9010, datë 13.02.2003 "Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta" dhe ti përshtatet mundësive teknologjike të riciklimit.

Në këtë rast duhet që dispozita për ruajtjen e dokumentacionit të ndryshojë që në thelb dhe të bazohet në:

- Përshtatjen e terminologjisë dhe llojit të dokumentacionit që duhet dorëzuar nga KZAZ-të në KQZ dhe të saktësojë pjesën e dokumentacionit që duhet të mbajë vet KZAZ – duke patur parasysh llojin dhe afatet e funksionimit të KZAZ-ve;

- Përshtatjen e terminologjisë dhe llojit të dokumentacionit që ka vlerë ligjore dhe historike për tu klasifikuar dokument që duhet të administruar dhe arkivuar nga Arkivi i Shtetit;
- Asgjësimi i fletëve të votimit dhe kundërfletëve të mos bëhet më me djegie, por me forma adekuate të riciklimit, duke ngarkuar KQZ-në për të caktuar me akte nën ligjore për format e riciklimit.

VI. NUMËRIMI I VOTAVE: FLETËT E VOTIMIT TË HEDHURA NË "KUTINË TË GABUAR"

Kodi Zgjedhor duhet ta trajtojë ceshtjen e numërimit të fletëve të votimit në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore. Regjimi I fletës së votimit të mos jetë e lidhur me kutinë e votimit. Kutia e votimit të konsiderohet si material zgjedhor që mban fletet e votimit të sigurta deri në momentin e numërimit. Kutia mund të numërohet me numra. Te gjitha kutitë e votimit të një qendre votimi të hapen njëkohësisht nga grupi i numërimit dhe fillimisht të ndahen sipas organit perkatës (gje e cila evidentohet menjehere në bazë të ngjyres së fletës së votimit) dhe me pas të kryhet numerimi për secilin organ dhe të plotësohet tabela perkatëse.

VII. ZGJEDHËSIT QË NUK MUND TË VOTOJNË VET

KQZ ka demonstruar gjithmonë një vullnet maksimal për të realizuar përshtatjen e kushteve për të mundësuar votimin e lirë dhe të fshehtë edhe për personat që nuk mund të votojnë vet, kryesisht personave me aftësi të kufizuar. Është shumë pozitive që Strategjia Kombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuar gjen zbatim progresiv edhe në dispozitat e Kodit Zgjedhor që prej vitit 2005, por ligjvënësi duhet të rregullojë identifikimin e autoriteteve përgjegjëse për zbatimin e këtyre dispozitave: Neni 108, pika 6 dhe 7 përcakton modalitetet që duhet të ndjekin zgjedhësit me aftësi të kufizuar për të informuar pushtetin vendor për kushtet e tyre dhe se ku do të votojnë, por nga ana tjetër, përgjegjësinë financiare për realizimin e këtyre nevojave nga pushteti vendor ja cakton KQZ-së!

Por:

- Praktikisht KQZ nuk ka asnjë mundësi dhe faktikisht nuk ka ndodhur që të marrë informacion as në kohë dhe as ditën e zgjedhjeve për numrin, vendndodhjen e zgjedhësve me aftësi të kufizuar, pasi ky është detyrim parësor i institucioneve të pushtetit vendor dhe Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale;
- Duke qenë se lista e zgjedhësve dhe vendet e qendrave të votimit janë detyrim i drejtpërdrejtë i pushtetit vendor, atëherë KQZ e ka të pamundur, për vet specifikën e kësaj problematike që të përcaktojë se: 1. ku dhe sa janë zgjedhësit me aftësi të kufizuar, 2. kushtet e paaftësisë së tyre; 3. mjetet ndihmëse që duhen vënë në funksion për të krijuar kushte për të ushtruar të drejtën e votës.

Në këto kushte, KQZ ka mundësuar në rang vendi kushtet vetëm për të verbrit – si detyrim i pikës 8 të nenit 108, por për kategoritë e tjera është e pamundur.

Në këtë rast duhet që neni 108, të plotësojë kuadrin e përgjegjësisë së Pushtetit Vendor dhe Ministrisë së linjës që është përgjegjëse për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Personat me aftësi të Kufizua, për detyrimin e pajisjes së QV-ve me mjete ndihmëse që lidhen me lëvizjen/transportin e zgjedhësve me aftësi të kufizuar dhe duhet të heqë detyrimin e KQZ-së për ta realizuar këtë proces me shpenzimet financiare të saj, pasi është një proces i pamundur dhe nuk bën gjë tjetër vetëm shmang përgjegjësinë e pushtetit vendor.

VIII. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I KZAZ-VE, KQZ-VE DHE GN-VE

Problematika e funksionimit të komisioneve zgjedhore të niveleve të dyta dhe të treta është sa politike aq edhe teknike. Gjithsesi, KQZ është përqendruar më tepër në propozime për ndryshime në procedurat e krijimit, organizimit dhe funksionimit të këtyre komisioneve, në mënyrë që të shmangen praktikat abuzive të cilat cojnë në bllokimin e procesit të votimit apo numërimit të votave. Këto problematika konsistojnë kryesisht në moszbatimin e detyrimit ligjor nga partitë politike për sjelljen e propozimeve për anëtarë të komisioneve të niveleve të ulta, në abuzimin me hapësirat që lë Kodi në lidhje me plotësimin e vakancave, kriteret për përzgjedhjen dhe emërimin e këtyre anëtarëve, si dhe përcaktimin e qartë të detyrave të këtyre komisioneve gjatë administrimit të procesit zgjedhor.

Duke patur parasysh këtë kuadër të gjerë problematikash, propozojmë që:

- Duhet të ndryshojë afati kohor për të plotësuar vakancën e krijuar në KZAZ, nga 15 ditë në 3 ditë. Gjithashtu gjatë ditës së zgjedhjeve propozimi për të plotësuar vendin vakant në KZAZ duhet të bëhet brenda dy orësh.
- Duhet përcaktuar saktësisht procedura dhe kategoria e personave të cilët do të emërohen kryesisht nga KQZ-ja, dhe jo vetëm për ditën e zgjedhjeve.
- Neni 30 duhet të përfshijë edhe anëtarë apo kandidatë për këshillat e bashkisë apo komunës përkatëse, kur ka zgjedhje për organet e qeverisjes vendore.
- Ashtu si për KZAZ-në dhe për KQV-të duhet të përcaktohet procedura dhe kategoria e personave të cilët do të emërohen kryesisht nga KZAZ-ja apo KQZ-ja nëse partitë të cilat kanë të drejtë të paraqesin anëtarë në KQV nuk e ushtrojnë këtë të drejtë.
- Shkak për shkarkimin e anëtarit të KQV-së duhet të jetë edhe rasti kur ai nuk paraqitet 2 orë rrjesht në detyrë ditën e zgjedhjeve.
- Afati kohor i marrjes së vendimit nga KZAZ-ja për ngritjen e grupeve të numërimit të votave, për caktimin e numrit të Grupeve të Numërimit, duhet të jetë jo më vonë se 10 ditë para ditës së zgjedhjeve. Gjithashtu, propozimi i partive politike për emërimin e anëtarëve të GN duhet të jetë jo më vonë se 1 javë para ditës së zgjedhjeve, ndërsa afati kohor i emërimit të anëtarëve të GN nga KZAZ-ja duhet të jetë të paktën 4 ditë para ditës së zgjedhjeve.
- Duhet të theksohet fakti se vetëm kandidatët e propozuar nga partitë politike për anëtar GNV-ve, të cilët kanë kryer programin e trajnimit dhe kanë kaluar testin kualifikues të përgatitur nga KQZ-ja, do të emërohen si të tillë nga KZAZ-ja përkatëse.

- Duhet të përcaktohet qartë kriteri i vendbanimit të anëtarëve të GNV-ve në rastin kur numërohen votat për Bashkinë e Tiranës.
- Duhet të përcaktohet qartë rasti kur brenda një grupimi politik, vetëm një parti politike ka më tepër se 2 mandate në Kuvend.
- Afati kohor për dorëzimin e materialeve nga selia e KZAZ-së, të jetë jo më vonë se 24 orë para hapjes së votimit, në mënyrë që për çdo problematikë të krijuar, të ekzistojë mundësia e ndërhyrjes në kohë për administrimin e zgjedhjeve në QV.
- Duhet qartësuar se "kush" ka detyrën të therrasë forcat e policisë së shtetit për vendosjen e rendit në QV: KZAZ-ja apo KQV-ja, pasi në dispozitën përkatëse këtë detyrë e kanë të dy këto komisione.

IX. REGJISTRIMI I KANDIDATËVE PËR KRYETAR, BASHKIE/KOMUNE

Kodi Zgjedhor aktual është i paqartë për regjistrimin e kandidatëve për kryetar komune apo bashkie. Ai ka parashikuar vetëm regjistrimin e kandidatëve për kryetar të propozuar nga zgjedhësit.

Kjo procedurë mund të regullohet duke shtuar një dispozitë e cila duhet të përcaktojë mënyrën e regjistrimit të kandidateve, për kryetar komune/bashkie.

Për sa i përket sanksioneve në lidhje me barazinë gjinore, praktika e zgjedhjeve të vitit 2011 tregoi se procesi i verifikimit të kriterit të gjinise në listat shumëemërore nuk u krye nga KZAZ-të. Prane KQZ nuk u depozitua asnjë vendim ku të evidentohet fakti nëse ishte shkelur ky kriter apo jo. Ky Verifikim u krye nga KQZ. Për shkak të volumit të punës rezikohet të respektohet afati 6 muaj nga momenti i kryerjes së shkeljes i cili parashikohe në nenin 17 të ligjit nr. 10279 "Per kundravajtjet administrative". Verifikimi kërkon një kohë më të gjatë. Një mënyrë që kjo procedure të mos jete në konflikt me nenin 17, pika 1 të ligjit të sipërcituar, Kodi Zgjedhor duhet të parashikojë afate të ndryshme për shqyrtimin e kësaj kundravajtje administrative. Ky afat mund të jete deri në 12 muaj nga momenti i kryerjes së shkeljes.

X. AFATET QË LIDHEN ME PERIUdhËN ZGJEDHORE

Neni 29 i Kodit, vendos kufizime për vakancën për anëtarët e KZAZ-ve duke diferencuar vakancën në periudhë zgjedhore dhe në periudhë jozgjedhore. Nisur nga përkufizimi i periudhës zgjedhore që Kodi bën ka mospërputhje midis kësaj periudhe dhe periudhës së krijimit dhe funksionimit të KZAZ-së. Ne mendojmë që plotësimi i vendit vakant të mos lidhet me periudhën zgjedhore.

Bazuar në të njëjtin arsyetim, mendojmë se duhet të rishikohet edhe afati i ngritjes së BMM. Kodi parashikon që BMM ngrihet 10 ditë para fillimit të periudhës zgjedhore, ndërkohë që referuar përkufizimit që jep Kodi për periudhën zgjedhore, BMM rezulton të ngrihet vetëm në dy data 5 mars ose 5 shtator. Kjo është e panevojshme pasi BMM ngrihet për të monitoruar

mediat vetëm për periudhën e fushatës zgjedhore. Afati i ngritjes së BMM duhet të jetë 10 ditë para fillimit të periudhës së fushatës zgjedhore dhe jo 10 ditë para fillimit të periudhës zgjedhore.

XI. ZEVENDESIMI I MANDATIT TE KESHILLTARIT TË B/K KUR MANDATIN E ZOTËRON KANDIDAT I MBESHTETUR NGA ZGJEDHËSIT

Neni 164 i Kodit Zgjedhor duhet të parashikojë edhe rastin e zëvendesimit të mandatit të këshilltarit të bashkisë dhe komunës kur mandati i ndërprerë i përket një kandidati të mbështetur nga zgjedhësit. Pranë KQZ-së janë paraqitur kërkesa të tilla ku në bashki apo komunë është ndërprerë mandati i këshilltarit i cili ishte më parë kandidatë i mbështetur nga zgjedhësit. Në këtë rast KQZ ka zbatuar për analogji nenin 164 të Kodit Zgjedhor i cili parashikon procedurën për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit kur mandati i ndërprerë i përket një kandidati të propozuar nga zgjedhësit dhe duke aplikuar këtë analogji mandati i takon subjektit zgjedhor me herësin më të lartë në baze të formulës të përcaktuar për ndarjen e mandateve.

XII.FINANCIMI I SUBJEKTEVE ZGJEDHORE

Sipas Kodit Zgjedhor subjektet zgjedhore kane disa detyrime për pasqyrmin e fondeve të shpenzuara dhe te përfituara për fushatën zgjedhore (neni 90).

Sipas përkufizimit, "subjekt zgjedhor" janë partitë politike, kandidatët për kryetar komune dhe bashkie, si dhe kandidatët e listave shumemërore dhe kjo do të thotë që detyrimet e nenit 90 te Kodit jane për partitë politike, kandidatët për kryetar bashkie/komune dhe kandidatet e propozuar nga zgjedhësit. Ndërkohë neni 90 pika 4 rithekson dhe një herë së detyrimet e këtij neni vlejné dhe për kandidatët e propozuar nga zgjedhësit duke lënë të kuptohet se këtë detyrim e kanë partitë politike dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit. Neni 91, parashikon gjithashtu se për cdo subjekt zgjedhor, KQZ emëron me short një ekspert kontabël për auditimin e fondeve te perftuara dhe te shpenzuara duke përdorur termin subjekt zgjedhor i cili nenkupton edhe në këtë rast parti/kandidat per kryetar/kandidat per keshill. Sipas mendimit tonë është e paqartë a do te ketë auditim për fondet e kandidatëve për kryetar të vecantë nga auditimi i fondeve të partisë.

Neni 92, pika 1 e Kodit Zgjedhor, ngarkon KQZ-në të përzgjedhë me konkurim një listë të ekspertëve kontabel të licensuar në fillim të vitit zgjedhor.

Hedhja e shortit dhe emërimi i ekspertëve të përzgjedhur si më lart, bëhet jo më vonë se 45 ditë nga dalja e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, përcaktuar kjo në nenin 91, pika 1 të Kodit Zgjedhor. Nga ekperienca e zgjedhjeve të përgjithshme për Kuvendin 2009, si edhe Zgjedhjeve për Organet e Qeverisjes Vendore 2011, rezultoi se nga momenti i përzgjedhjes së listës, deri në momentin e emërimit të ekspertëve, krijohet një interval kohe mesatarisht 6 muaj, kohë gjatë së cilës mund të ketë ndryshime në listen e ekspertëve të përzgjedhur nga KQZ. Këto ndryshime mund të vijnë për shkak të:

- Shtimit në listë të ekspertëve të rinj të cilet gjatë kësaj periudhe mund të plotesojnë kriterin e ekperiencës të përcaktuar nga Kodi Zgjedhor (neni 92, pika 2) - të kenë 5 vjet që e ushtrojnë këtë profesion.
- Duhet të ketë shkurtim të listës së ekspertëve për shkak të daljes në pension dhe mos ushtrimit me te profesionit.
- Shkurtim të listës së ekspertëve për shkak të masave të mundshme disiplinore.

Propozimi ynë është që përzgjedhja e listës dhe emërimi i ekspertëve të bëhet në të njëjtin moment.

Dorëzimi i raporteve financiare në KQZ nga ana e subjekteve zgjedhore, në momentin e mbylljes së fushatës si edhe qartësimi i momentit të bërjes publike të informacionit financiar nga ana e KQZ-së:

Kodi Zgjedhor parashikon mbajtjen e të dhënave për dhurimet si edhe për shpenzimet për fushatën zgjedhore nga ana e partive politike, si edhe ngarkon KQZ-në të bëjë kurdoherë publike listën e donatorëve që dhurojnë shuma mbi 100 mijë lekë, ndërkohë që nuk i detyron partitë politike të dorëzojnë raporte financiare apo informacione të tjera në lidhje me dhurimet apo shpenzimet e fushatës. Ky informacion i vihet në dispozicion ekspertit të licensuar të emëruar nga KQZ në momentin e fillimit të auditimit.

Ne propozojmë që në Kodin Zgjedhor të shtohet detyrimi i partive politike që të dorëzojnë informacion në KQZ në lidhje me dhurimet si edhe shpenzimet e fushatës menjëherë me mbylljen e fushatës zgjedhore.

Gjithashtu, përcaktimi i bërë në nenin 90, pika 1 të Kodit Zgjedhor, që lista e dhuruesve që dhurojnë shuma mbi 100 mijë lekë të bëhet kurdoherë publike, duhet të ndryshohet duke e lidhur bërjen publike të listës së dhuruesve me dorëzimin e informacionit financiar nga ana e subjekteve zgjedhore në KQZ. Në këtë mënyrë duhet të qartësohet momenti i bërjes publike i listës së personave që dhurojnë shuma mbi 100 mijë lekë.